




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



# EDUKIMI NE KARRIERË

(DORACAKU PËR MËSIMDHËNËS)



Implementet by





# EDUKIMI NE KARRIERË

(DORACAKU PËR MËSIMDHËNËS)

*Ky material është hartuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft Für International Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane.*

*Përmbajtja e tekstit original është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft Für International Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo të Qeverisë Gjermane.*

**Autore e Doracakut:**

Lumnije Mehmetaj

**Koordinuar nga:**

Nexhmedin Basha, GIZ

Alberta Alihajdari, GIZ

**Dizajni dhe faqosja nga:**

Envinion

Prishtinë, Gusht 2023

# PËRMBAJTJA

Hyrje.....	6
Përmbajtja e moduleve.....	7
Moduli i parë.....	8
1. Vetë-ndërgjegjësimi:.....	12
1.1 Kush jam unë.....	12
1.2 Testi i vlerave.....	15
1.3 Testi i karakteristikave personale.....	18
1.4 Testi i interesave.....	20
1.5 Idhulli (Heroi) im.....	22
1.6 Një letër për vetën time.....	23
1.7 Stilet e të mësuarit.....	23
1.8. Pengesat për suksesin tim.....	30
1.9. Kodet e personalitetit-Testi Holland.....	34
1.10. Vendosja e qëllimeve (Sesioni 1).....	41
1.11 Vendosja e qëllimeve (Sesioni 2).....	43
2. Informacione në lidhje me profesionet.....	46
2.1 Eksplorimi i grupeve të profesioneve-karrierës (Sesioni 1).....	46
2.2 Eksplorimi i grupeve të profesioneve-karrierës (Sesioni 2).....	47
2.3 Planifikimi i karrierës.....	48
2.4 Çfarë pune bëni?.....	50
Moduli i dytë.....	51
3. Opsionet e shkollimit dhe karrierës:.....	52
3.1 Rugët e shkollimit dhe profesionit.....	52
3.2 Kriteret për zgjedhjen e shkollës.....	54
3.3 Trajtimi i informacioneve.....	56
3.4 Intervista për profesionet dhe rrugët e shkollimit.....	57
4. Takimet reale.....	59
4.1 Përgatitjet për takimet reale për hulumtimin e profesioneve.....	59
4.2 Aplikimi për trajnim dhe punë, CV-të.....	63
5. Vendimi për zgjedhjen e profesionit.....	64
5.1 Preferencat personale në marrjen e vendimit për zgjedhjen e shkollës/profesionit.....	64
5.2 Marrja e vendimit për karrierë.....	70
5.3 Plani i veprimtimit për karrierë.....	73
Referencat.....	78

# Hyrje

Menaxhimi i të mësuarit, punës, kohës së lirë dhe tranzicioni në mjedisin profesional të punës është një proces dinamik, kompleks dhe specifik, i cili është i ndikuar nga shumë faktorë personal dhe social. Transformimi digjital, globalizimi, ndryshimet demografike, ndryshimet klimatike dhe krizat globale si pandemia Covid-19 e bëjnë procesin e të mësuarit dhe të punës më komplekse. Siq është situata tani, individët sfidohen dhe përballen me tranzicione më të shpeshta dhe më komplekse nderkohë që ata janë duke ndjekur arsimin e tyre dhe eksplorojnë mundësitë e punës. Kjo situatë thërret dhe indikon nevojën për shërbime të edukimit dhe këshillimit në karrierë.

Modulet janë menduar që të përdoren nga mësimdhënësit apo profesionistët e tjerë që punojnë me nxënës. Materiali në modul specifikisht trajton nxënësit që janë në fazën e marrjes së vendimeve për arsimin e mesëm të lartë. Qëllimi i këtyre moduleve është që t'u ofrojë mësimdhënësve një prezantim të edukimit në karrierë, dhe disa teknika për të komunikuar me nxënësit dhe për të integruar planifikimin e karrierës në programin shkollor me qëllim të përgaditjes së nxënësit për të marrë vendime që lidhen me karrierë, që paraqiten në vitet e tyre të fundit të arsimit të detyrueshëm.

Kuptimi i procesit dhe të teknikave të edukimit në karrierë tregon se si nxënësit mund të zhvillojnë vetë ndërgjegjësimin e tyre dhe të identifikojnë llojin e punës apo të shkollimit të cilit i përshtaten më së miri. Pra, theksi është mbi nevojën që nxënësit të zhvillojnë përgjegjësinë dhe të jenë zot të vendimeve të tyre nëpërmjet proceseve të përdorura në edukimin në karrierë. Edukimi në karrierë do të duhej ta përmirësonte këtë proces, por do të zhvilloj dhe aktivitetet për të kuptuar tregun e punës, ku planifikimi i lëvizjes (tranzicionit) më shpesh i përshtatet grupeve ku mbështetja nga

ana e profesionistëve shfrytëzohet në mënyrë më efektive.

Modulet janë hartuar për të fuqizuar nxënësit që të marrin përgjegjësinë për të ardhmen e tyre dhe i angazhon nxënësit në aktivitetet e zhvillimit të karrierës. Këto materiale u mundësojnë atyre të identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta personale dhe të vendosin qëllime të afatshkurta dhe të afatgjatë për të arritur njohuritë dhe shkathtësitë akademike, social-emocionale dhe vendin e nevojshëm të punës për suksesin e ardhshëm.

Në përgjithësi, i tërë materiali i përfshirë është i bashkangjitur me disa ushtrime që do tu shpërndahen nxënësve; ato janë materiale udhëzuese me disa të dhëna ndihmëse që kanë të bëjnë me specifikat e aktiviteteve të “karrierës” si p.sh. njohja e vetës, etj. Modulet ofrojnë materiale për aktivitete në klasë. Ushtrimet e përfshira në këto module janë menduar të jenë të lehta për tu lexuar dhe për tu kuptuar nga nxënësit, madje këto ushtrime janë mjaftë argëtuese!

Është gjithashtu esenciale për shkollat që të sigurojnë informata për karrierë nëse duan që nxënësit të marrin përgjegjësinë për hulumtimin e tregut të punës dhe të mësojnë vetë për botën e punës.

## Përmbajtja e moduleve



Gjatë hartimit të modulit të parë janë marrë parasysh trendet e fundit në botë në fushën e orientimit në karrierë ku është inkorporuar edhe shëndeti mendor. Bazuar në këtë fakt, në kuadër të ushtrimeve për nxënës janë inkorporuar elemente të mësimit socio-emocional, për arsye që tani fokusi në edukimin/këshillimin në karrierë ka ndryshuar nga testimi i nxënësve në reflektimin e nxënësve se **Kush Jam Unë**.



Së pari, moduli i parë i trajnimit përfshinë hapin e parë dhe të dytë të modelit, i cili në total përmban pesë hapa (**vetë-ndërgjegjësimi dhe informacione në lidhje me profesionet**), pastaj, moduli i dytë i trajnimit përfshinë hapin e tretë, të katërt dhe të pestë të modelit pesë hapësh (**opsionet e shkollimit dhe karrierës, takimet reale, vendimi për zgjedhjen e profesionit**).



## Moduli i parë

Ky modul ofron një kuptim se si interesat, talentet dhe aspiratat unike të dikujt luajnë një rol në vendimmarrje dhe në marrëdhëniet ndër personale. Mendimet dhe ndjenjat individuale që i emocionojnë nxënësit për jetën dhe mësimin, aftësinë për të artikuluar pasionet dhe ëndrrat, dhe njohjen e sfidave dhe barrierave të mundshme për arritjen e qëllimeve dhe mënyrën se si stilet e jetesës së shëndetshme kontribuojnë në suksesin personal dhe profesional, të gjitha luajnë një rol në krijimin e një pasqyre të studentit, dhe na jep një ide bazike për dëshirat e tyre në karrierë.

Elementi 1: Nxënësit do të demonstrojnë njohuri, mirëkuptim dhe vetëdije personale për talentet, interesat, shpresat, ëndrrat dhe pasionet e tyre individuale.

Nxënësit do të (jenë në gjendje të):

- marrin pjesë në ushtrime/vlerësime të vetë-zbulimit për të filluar procesin e zbulimit të talenteve, interesave dhe aspiratave potencialisht të fshehura;
- identifikojnë karakteristikat dhe atributet unike që e dallojnë atë nga njerëzit e tjerë dhe e lejojnë ata që të shprehen si individë;
- të artikulojnë, nëpërmjet esesë së shkruar ose punës tjetër krijuese, se si atributet e saj/tij unike mund të kontribuojnë ose mund të pengojnë suksesin e tyre akademik dhe/ose në karrierë.

Elementi 2: Nxënësit do të demonstrojnë vetëdije personale dhe pjekuri sociale nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve pozitive me bashkëmohatarët, mësimdhënësit dhe të rriturit e tjerë.

Nxënësit do të (jenë në gjendje të):

- të mësojnë se si të zhvillojnë një rrjet personal/profesional të mentorëve të rritur që ata mund të kenë qasje për udhëzime dhe mbështetje gjatë zhvillimit të qëllimeve të

karrierës ose të shkollës së mesme të lartë;

- marrin pjesë në vlerësime specifike që identifikojnë cilësi unike, individuale, udhëheqëse. Këto cilësi udhëheqëse mund të zhvillohen dhe përmirësohen nëpërmjet praktikës dhe vetë-reflektimit;
- fillojnë të zhvillojnë dhe praktikojnë aftësitë e vetë-avokimit dhe të jenë në gjendje të pohojnë veten përmes përdorimit të komunikimit të duhur me gojë dhe me shkrim.

### Informacione në lidhje me profesionet

Njohuri për ndryshimin midis vendeve të punës, profesioneve dhe karrierës.

Ndërgjegjësimi për një gamë të gjerë rrugësh dhe mundësish të karrierës në tregun lokal, kombëtar dhe global, duke marrë parasysh ndikimet ekonomike, kulturore dhe ndikimin e stereotipave në zgjedhjen e karrierës.

Elementi 1: Nxënësit do të zhvillojnë njohuri, mirëkuptim dhe vetëdije personale për rrugët e karrierës të disponueshme në arenat lokale, rajonale, kombëtare dhe globale.

Nxënësit do të (të jenë në gjendje të):

- identifikojnë një grup të profesioneve për të cilët ata janë të interesuar duke u informuar për mundësitë në tregun lokal, rajonal, kombëtar dhe global
- emërtojnë grupet e profesioneve të identifikuara në platformën Busulla<sup>1</sup>

Elementi 2: Nxënësit do të jenë në gjendje të kuptojnë ndikimet ekonomike dhe ndikimet e tjera të ndryshme në rrugët e karrierës.

Nxënësit do të (të jenë në gjendje të):

- identifikojnë se si zgjedhja e një profesioni të caktuar mund të ndikojë në stilin e jetës së tyre në të ardhmen;

<sup>1</sup> Busulla është platformë kombëtare për orintim në karrierë e cila përmblen teste për vetëvlerësimin e nxënësve, informacione rreth shkollave, video dhe përshkrime të profesioneve të ndryshme në Kosovë



- identifikojnë dhe përdorin më shumë se një burim që do t'i informojnë ata për profesione specifike.

Përmbajtja e modulit të parë do të jetë si më poshtë:

- 1 **Vetë-ndërgjegjësimi:** Kush jam unë (shkathësitë, cilësitë, vlerat, talentet), Idhulli (heroi) im- përshkrimi i shkathësive dhe cilësive të një personazhi të admiruar, Një letër për veten time, stilet e të mësuarit, çfarë më pëlqen dhe nuk më pëlqen, pengesat për suksesin tim, testi i personalitetit - Kodi i Hollandit, Vendosja e objektivave (afat- shkurtër dhe afat-gjatë), Objektivat SMART
- 2 **Informacione në lidhje me profesionet:** Eksplorimi i grupeve të profesioneve-karrierës (Hulumtimi dhe analizimi i tre grupeve të zgjedhura të profesioneve dhe informimi për vendet e punës për të kuptuar botën e punës), planifikimi i karrierës (Informimi për vendet e punës për të kuptuar botën e punës), çfarë pune bëni (Hulumtimi dhe informimi për profesionet e familjarëve dhe mënyrat si kanë gjetur punë)

### Moduli i dytë - Opsionet e shkollimit dhe karrierës, Takimet Reale dhe Vendimi për zgjedhjen e profesionit

Ky modul u ndihmon nxënësve të marrin informacione rreth shkollave në rajonin e tyre, të kuptojnë kriteret për regjistrim në shkollat e mesme të larta, si dhe të përgatiten për takime reale. Pas marrjes së informacionit dhe pocesimit të tyre, nxënësit mësojnë se si të marrin një vendim të mirë dhe të informuar për karrierën dhe të përgatisin një plan veprimi.

Në mënyrë që nxënësve t'u ndërmjetësohen kompetencat orientuese për zgjedhjen e shkollës dhe të profesionit, ata fillimisht duhet të merren me ofertat informuese që u interesojnë atyre në zgjedhjen e shkollës dhe të profesionit. Kjo bëhet duke hulumtuar ofertat informuese që u interesojnë,

selektimin e tyre, dhe duke siguruar në mënyrë të pavarur informacione relevante nga interneti (Busulla.com) dhe nga burime të tjera informative në lidhje me sektorët e profesioneve dhe imazhet e profesioneve, mundësitë e shkollimit etj.

Pasi nxënësit njohin interesat dhe aftësitë e tyre nëpërmjet informacionit dhe hulumtimit të mundësive, të kenë zhvilluar aftësinë e tyre orientuese, dhe të jenë të informuar për mundësitë profesionale dhe rrugët e shkollimit, ata mund të krahasojnë profilin e personalitetit të tyre me kërkesat e botës profesionale. Nxënësit ndoshta e kanë provuar praktikisht, specifikisht, se çfarë ndodh në shkollë dhe në punë, tani ata mund të marrin vendimin për shkollën/profesion e ardhshëm.

Nxënësit do të (jenë në gjendje):

- të kuptojnë rrugët e larmishme të shkollimit me kërkesat e tyre
- të qartësohen nëpërmjet takimeve reale në botën e shkollës dhe të profesioneve
- të jenë në gjendje të ndërtojnë strategji personale për planifikimin e jetës dhe të profesionit të tyre
- të jenë në gjendje të krahasojnë profilin e personalitetit me profilin e kërkesave për rrugën e shkollimit dhe profesionit dhe të verifikojnë vendimin e marrë.

Përmbajtja e modulit të dytë do të jetë si më poshtë:

- 1 **Opsionet e shkollimit dhe karrierës** (Rrugët e shkollimit dhe profesionit, kriteret për zgjedhjen e shkollës, shqyrtimi i rezultateve të informimit, Intervista për profesionet dhe rrugët e shkollimit)
- 2 **Takimet reale** (Përgatitjet për takimet reale për hulumtimin e profesioneve, aplikimi për trajnim dhe punë - CV-të)
- 3 **Vendimi për zgjedhjen e profesionit** (Preferencat personale në marrjen e vendimit për zgjedhjen e shkollës/profesionit, marrja e vendimit për karrierë, rëndësia e prindërve gjatë marrjes së vendimit, plani i veprimi).

### Rezultatet Mësimore - Harmonizimi me konceptet e Kornizës Kurrikulare të Kosovës dhe dokumentet operative Kurrikulare.

Edukimi në Karrierë ofrohet nga mësimdhënës të përgatitur dhe me kompetencë profesionale. Mësimdhënësit do ndihmojnë nxënësit që krahas njohurive që do përfitojnë në fushat kurrikulare, të lehtësojnë edhe zhvillimin gradual të tyre duke trajtuar çështjet sipas thellësisë së problematikave (klasa 6 - 9). Përmbajtja e materialit mësimor u mundëson mësimdhënësve por edhe vetë nxënësve, që të përcjellin zhvillimin si në aspektin kognitiv ashtu dhe në zhvillimin e kompetencave të tyre të parapara me Kornizën Kurrikulare.

Kompetencat që duhet të zhvillohen tek nxënësit, përcillen në linjë vertikale, nga klasa e 6 deri 9 dhe kontrollohen përmes rezultateve të përcaktuara për shkallë kurrikulare.

Mësimdhënësit duke integruar programin e trajnimit të „Edukimit në Karrierë” në mësimdhënien e tyre lëndore janë në harmoni me konceptin bazë të Koncepteve të Kornizës Kurrikulare - integrimi i lëndëve/ fushave mësimore, me një mësimdhënie bazuar në konceptin „Gjenerim i informacionit” për dallim nga koncepti i vjetër „Interpretim i informacioneve”.

Përmbajtja e doracakut „Edukimi në Karrierë” siguron parapërgatitje të nxënësve për një:

- Vendimmarrje të analizuar,
- Konkurrencë të suksesshme në rrugëtimin e shkollimit të tyre dhe pritshmërive të tyre,
- Karrierë të suksesshme.

Kurrikula Bërthamë si dokument operativ sqaron obligimet e mësimdhënësit në procesin e mësimdhënies, siguron integrimin e fushave kurrikulare në shtrirje horizontale ashtu në zhvillimin e përmbajtjeve në vijë vertikale.

Programi „Edukimi në Karrierë” mbështet në rend të parë konceptet e fushës kurrikulare Jeta dhe Puna (6-9) siç janë:

- Puna dhe edukimi për ndërmarrësi,
- Këshillimi dhe orientimi në karrierë,
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, por edhe konceptet e fushave të tjera kurrikulare, p.sh.;
- Gjuha figurative dhe jo figurative – Gjuhët dhe komunikim,
- Proceset shoqërore dhe natyrore; Vendimmarrja dhe institucionet – Shoqëria dhe mjedisi,
- Bota e gjallë, përmes temës „Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut” – Shkencat e natyrës,
- Përpunimi i të dhënave dhe probabiliteti – Matematikë,
- Krijimtaria dhe performanca artistike – Artet.

Edukim në Karrierë kontribuon në zhvillimin e njohurive të nxënësve edhe për çështjet ndërkurrikulare;

- Globalizmi dhe ndërvlerësia,
- Edukim për zhvillim të qëndrueshëm,
- Edukim për qytetari demokratike,
- Arsim për zhvillim të qëndrueshëm, etj.

Mësimdhënësit, që të arrijnë qëllimet e tyre në realizimin e rezultateve të pritura duhet që me metodologjitë e punës të mundësojnë ndërlidhjen e përmbajtjes së Edukimit në Karrierë me përmbajtjet e lëndëve të caktuara duke i përkthyer në situata jetësore reale apo simulative dhe kështu kontribuohet edhe në zhvillimin e kompetencave të shkallës III-të dhe IV-të kurrikulare, në veçanti në zhvillimin e:

- Kompetencës komunikim dhe të shprehur,
- Kompetencën e te menduarit kritik,
- Kompetencës të mësuarit për të nxënë,
- Kompetencës për jetë, punë dhe mjedis.

Deri në përfundim të shkallës III-të kurrikulare programi synon që të mbështet nxënësit në tejkalimin e sfidave për:

- Kultivimin e interesimit për njohjen e vetes dhe mjedisit shoqëror,
- Zhvillimin e aftësive për vetëvlerësim,
- Komunikim efektiv përmes formave të ndryshme,
- Zhvillimin e kompetencës personale, përgjegjshmërisë dhe vendimmarrjes.

Ndërsa deri në përfundim të shkallës së IV-të kurrikulare programi synon të mbështet nxënësit në tejkalimin e sfidave për:

- Shfrytëzim të burimeve të ndryshme të informacioneve me një qasje kritike ndaj të gjeturave të ndryshme,
- Përfshirje të drejtpërdrejte në aktivitete jashtëshkollore,
- Konsolidim të dijeve dhe zhvillim të mëtutjeshëm të shkathësive në harmonizim me jetën reale,
- Hulumtim të mundësive për vazhdim të shkollimit të mëtutjeshëm për një karrierë të pritshme,
- Planifikim të aktiviteteve dhe përgatitje praktike të aktiviteteve orientuese drejt aspiratave,
- Përforsim të vetëvlerësimit dhe vendimmarrje bazuar në dëshmi.

Konkludojmë se programi i trajnimit „Edukim në Karrierë” mbështet drejtpërdrejte:

- Nxënësin - në zhvillimin gradual personal, në zhvillimin e kompetencave bazuar në kërkesat e standardizuara dhe në harmoni me moshën e tyre për një arsimim të qëndrueshëm dhe tërëjetësor me mundësi të integritit sa më të lehtë në rrjedha shoqërore për një përballje me sfidat e jetës në kontekste të ndryshme.
- Mësimdhënësin - për një planifikim dhe realizim të suksesshëm të punës me nxënësin në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore si dhe për një këshillim sa më të lehtë në edukimin e tyre për karrierë.

Në mënyrë të tërthorët programi mbështet prindërit që të:

- Përcjellin ndryshimin e vazhdueshëm dhe nivelin e zhvillimit të fëmijëve të tyre,
- Përcjellin zhvillimin e kompetencave të fëmijëve të tyre në harmoni me moshën,
- Krijojnë marrëdhënie mirëbesimi në rastin e vendimmarrjes për shkollim të mëtutjeshëm dhe synim të një profesioni të dëshiruar.

Edukim në Karrierë sipas modelit prej 5 hapave mundëson një orientim procesual dhe gjithëkontribues të mësimdhënësve të të gjitha fushave kurrikulare.

Praktikisht përmes integritit të programit „Edukim në Karrierë” nëpër gjitha lëndët mësimore, ofrohen mundësi nxënësve që në harmoni me talentet e tyre në mënyrë të pavarur të zhvillojnë kompetencën e tyre personale për zgjedhjen e profesionit, të marrin vendimin e parë për profesionin e preferuar përmes njohjes së vetvetes, përpunimit të informacioneve si dhe takimeve me botën reale.

Procesi i integritit duhet të jetë i orientuar drejt qëllimit dhe të bëhet në bashkëpunimin mësimdhënës – nxënës pa trysni për të arritur rezultate. Të mësuarit e përbashkët aktiv ndikon në një atmosferë pune pozitive dhe stimulon trajtim intensiv të tematikës.

Është detyrë e rëndësishme e arsimit që të ndihmojë nxënësit të bëhen të aftë për punë dhe njëkohësisht të nxjerrin në pah ato kompetenca që i mbajnë të përgatitur për punë. Kjo fillon në shkollimin bazë. Kjo vlen edhe për karakteristikat personale dhe sociale, ku shpeshherë nxënësit sfidohen në mjedisë të reja shoqërore, kulturore, demografike, mjedisë pune, etj.

Edukimi në karrierë mbështetet në parimin ndërveprues. Koncepti nisët nga fakti, që ndikimet e nevojshme mund të arrihen veçanërisht atëherë kur procesi i edukimit në karrierë shihet në radhë të parë si:

- 1 Procès i të nxënësit,
- 2 Procès korrespondues i orientuar drejt së ardhmes – në kuptimin dinamik,
- 3 Kompetencë vendimmarrëse.

Qëllimet e Edukimit në Karrierë në kontekst të zhvillimit të kompetencës personale në zgjedhjen e profesionit, janë që nxënësit;

- të zbulojnë, hulumtojnë dhe qartësojnë dëshirat, interesat dhe prirjet e tyre,
- të perceptojnë talentet dhe aftësitë e tyre,
- të njohin profilet e kërkesave të profesionit dhe të shkollës,
- të thellohen më tej në marrjen e informacioneve për mundësitë e shkollimit dhe për profesionet,
- të dallojnë format aktuale si edhe ndryshimin e punës dhe të profesioneve,
- ta njohin botën e punës dhe të profesioneve në këndvështrime kulturore, ekonomike, sociale dhe ekologjike,
- të dallojnë ndikimet e teknologjive të reja në fusha të ndryshme të profesioneve dhe të jetës,
- të mendojnë për dimensionet e shëndetit si faktor në punë dhe në profesion,
- të qartësohen nëpërmjet takimeve reale në botën e shkollës dhe të profesioneve,
- të jenë në gjendje të ndërtojnë strategji personale për planifikimin e jetës dhe të profesionit të tyre,
- të jenë në gjendje të krahasojnë profilin e personalitetit me profilin e kërkesave për rrugën e karrierës në shkollë dhe profesion dhe të verifikojnë vendimin e marrë.

Edukimit në karrierë mund të ofrohet në shkollë si lëndë mësimore, në formë projekti dhe në formë të integruar në lëndë të ndryshme mësimore. Cilado mënyrë e zbatimit mbartë përparësitë dhe sfidat gjatë zbatimit.

Ne rastin tonë mësimdhënësit do t'i ngrisin kapacitetet profesionale në mënyrë që zbatimi i Edukimit në Karrierë të mundësohet si i integruar në lëndët mësimore;

- Mësimi për edukimin profesional i integruar me lëndët e tjera mësimore kërkon shumë punë koordinuese.
- Nuk orientohemi shumë sipas planit mësimor.
- Kompetenca orientuese mund të zhvillohet dhe të mbështetet në mënyrë të vazhdueshme.

Si mund të integroj një mësimdhënës në planifikim të orës mësimore aktivitete /rezultate të të nxënësit nga Edukimi në Karrierë në procesin e një nxënies nga lënda tjetër?

Një skenar ore i përgatitur në mënyrë profesionale mundëson që në çdo fazë të orës mësimore të kontribuohet në edukimin e nxënësve për një karrierë të mirë analizuar dhe planifikuar. Parashtrimi i pyetjeve të hapura, plotësimi i pyetsorëve, angazhimi në formë të detyrave, debateve etj. janë veprimet e duhura, p.sh. :

- Lënda mësimore ..... në cilat profesione kërkohet?
- Komento se në cilat situata jetësorë do i përdorni njohuritë e fituara nga .....
- Vlerëso aftësitë tuaja në rast të zbatimit të njohurive të fituara nga .....
- Njohuritë e fituara sa do ju ndihmojnë në shkollimin tuaj të mëtutjeshëm?
- Në cilat profesione kërkohen këto njohuri të fituara nga .....
- Shpjegoni përfitimet nga kjo përmbajtje mësimore, në rrugën tuaj të karrierës.
- Etj.

Këto kërkesa dhe shumë të tjera të formuluar në formë të rezultateve të të nxënësit, do jenë zgjidhja e synuar me programin „Edukim në Karrierë”.

Moduli

1

# 1. Vetë-ndërgjegjësimi:

## 1.1 Kush jam unë

### Aktiviteti 1.

Mësimi “Kush jam unë” është krijuar për të ndihmuar të rinjtë të zbulojnë talentin dhe aftësitë e tyre në zhvillim, duke përdorur një strategji më narrative dhe diskutimi përpara përdorimit të mjeteve tradicionale të vlerësimit (p.sh. profilizuesi i interesit, gjetja e grupeve të karrierës). Qëllimi është t’u tregohet nxënësve se aftësitë njerëzore që ata identifikojnë, mund të përdoren për të përshkruar “kualifikimet” e tyre të punës.

Ky mësim u mundëson nxënësve që të eksplorojnë mënyra për të përshkruar veten e tyre.

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- **Përshkruajnë se çfarë i bën unik**
- **Gjejnë mbiemra që përshkruajnë veten që mund të lidhen me karrierën**

#### Gjithë grupi

Nxënësit shkruajnë, në mënyrë të pavarur, tre fjalë që përshkruajnë se kush ishin ata para shkollës së mesme të ultë.

**Diskutim:** Si do ta përshkruani veten kur ishit në shkollën fillore? Si keni ndryshuar?

#### Gjithë grupi individualisht

Për këtë aktivitet së pari nxënësit lexojnë tabelën me aftësi dhe identifikojnë 5 kategori që lidhen me aftësitë e karrierës për t’u marrë parasysh. Nxënësit do të identifikojnë aftësitë që i kanë aktualisht dhe aftësitë që po punojnë për t’i ngritur.

Nxënësit shkruajnë shkathësitë e tyre në një fletë pune.

#### Grupe të vogla (10 minuta)

**Diskutimi:** Secili person ndanë aftësitë që ka dhe aftësitë të cilat synon t’i arrijë me punë. Pasi secili person të ketë ndarë ato, identifikoni dy aftësitë që më shumë se një person i kanë të pëbashketa si dhe ato që po punojnë për të përmirësuar. Si grup, krijoni një rekomandim se si ju keni ndërmend t’i përmirësoni këto aftësi .

#### Reflektim

Gjithë grupi

**Diskutim:** Ndani dhe diskutoni rekomandimet tuaja nga secili grup në klasë pasi të kenë lexuar dhe rrumbullaksuar 5 aftësi nga tabela e aftësive. Në fund, në fletën e punës (profili personal) i shkruajnë 5 prioritete ku përfshihen edhe vlerat, karakteristikat personale dhe interesat.

Nxënësit i ndajnë informatat kthyesë të këtij mësimi me mësimdhënësin.

**Detyrë shtëpie-** inkurajoni nxënësit të pyesin anëtarët e familjes ose dikë të afërt për mënyrat në të cilat ata e kanë përshkruar veten në një kontekst profesional ose në punë.

Këtu janë disa shembuj të aftësive. Rrethoni çdo aftësi që mendoni se i posedoni. Nëse disa aftësi të rëndësishme mungojnë, shkruani ato në fletën më poshtë.

Ndihmoj të tjerët (të dëgjuarit, i /e arsyeshme)	Japë udhëzime, informacione	Operoj me makina/ pajisje të rënda
Mësoj gjëra të reja	Negocioj	Prezantoj (flasë në publikë)
Punoj me të tjerët	Zhvilloj strategji	Marre vendime
Montoj gjë-sende	Shkruaj (gramatika, drejtshkrim)	Përgatis tekste, dokumente
Këndimi/këndo	Japë mësim/mësimdhënës Japë mësim (mësimdhënës/se)	Parashikoj pasojat
Klasifikoj objekte, dokumente	Hulumtoj	Shes
Kuptoj/flasë gjuhë të huaja	Planifikoj	Riparoj (kompjuterë, gjëra)
Kompozoi (tekst, muzikë)	Improvizoj	Bëj përmbledhje (summarizing)
Vozisë/ngasja e makinës	Punoj punë fizike	Zgjidhi probleme
Redaktoj/korrigjoj tekste	Menaxhoj mirë stresin	Punoj me numra
Krijoi / Shpikja	Krijoi sisteme/procese	Përdor kamera/pajisje
Punoj në mënyrë të pavarur	Intervistoj njerëzit	Përdor software të ndryshëm
Konsultohem me njerëz	Luaj një instrument muzikor	Përdor aparatura në laborator
Vizatoj/reproduksion	Lexoj dhe kuptoj domethënien	Përdor mjetet (sharrë, çekiç)
Drejtoj diskutimin në grup	Hulumtoj online	Trajtoj kafshët
Dhënia e këshillave të mira	Analizoj (tekstin, të dhënat )	Bëj listën (e gjërave, priorite- teve)
Krahasoj (gjërat, të dhënat )		

Aftesitë e tjera që nuk janë në këtë listë:

---



---



---



---



---



---

## 5 Aftësitë më të rëndësishme:

- 1 \_\_\_\_\_
- 2 \_\_\_\_\_
- 3 \_\_\_\_\_
- 4 \_\_\_\_\_
- 5 \_\_\_\_\_

**Udhëzime për mësime dhënësit**

- Shpërndani listën e aftësive dhe jepni sqarimet e duhura për plotësim.
- Kërkoni nga ata që të përdorin shenja dhe të rrumbullaksojnë për të shënuar aftësitë për t'ju ndihmuar të përcaktoni se cilat janë më të rëndësishmet.
- Përfundoni aktivitetin duke diskutuar me nxënësit se si aftësitë që ata po zhvillojnë, do të vazhdojnë të rriten gjatë jetës së tyre. Derisa ata mendojnë të përshkruajnë veten e tyre tani, mbani mend se shkathhtësitë mund të fitohen dhe ngritën gjatë gjithë jetës së tyre.
- Në të njëjtën mënyrë që kanë ndryshuar në vitet e fundit, ata mund të vazhdojnë të ndryshojnë ndërsa mësojnë aftësi dhe shkathhtësi të reja dhe zhvillojnë ato që tashmë i kanë mësuar në vitet e fundit.
- Kjo detyrë mund të përfundojë shpejt. Grupe të vogla mund të formohen, gjer sa nxënësit mbarojnë ushtrimin, për të siguruar që ata që kanë nevojë për më shumë kohë që të jenë në gjendje të përfundojnë atë.
- Ky reflektim mund të bëhet në mënyrë të pavarur përpara se nxënësit të përfshihen në diskutimin në grup, varësisht nga koha.



## 1.2 Testi i vlerave

### Ushtrimi 1: Ushtrimi me 5 vlerat kryesore

Merrni pak kohë me ushtrimin e vlerave bazë për të vlerësuar me vetëdije se çfarë ka vërtetë rëndësi për ju. Identifikimi i vlerave tuaja do ta bëjë shumë më të lehtë për ju të kuptoni se si duhet të rregulloni atë që po bëni në jetën dhe punën tuaj. Pra, çfarë është me të vërtetë e rëndësishme për ju? Cilat janë gjërat që ju bëjnë të ndiheni se po bëni vërtet atë që jeni të destinuar të bëni? Cilat aktivitete ju bëjnë të ndiheni të plotësuar dhe të kënaqur? Çfarë është ajo që iu bën juve kaq të veçantë?

Zakonisht është fakt që një vlerë thelbësore po përmbushet – diçka si sfidë, argëtim, kontribut ose porosi. Ato ndryshojnë për secilin prej nesh.

Këtu janë disa shembuj të vlerave. Rretho çdo vlerë që mendon se posedoni. Nëse disa vlera të rëndësishme mungojnë, shkruani ato në fletën me poshtë.

Bukuria	Pa-anësia	Paqja
Sfida	Fama	Zhvillimi personal
Ndryshimi	Familja	Shprehjet personale
Komuniteti	Lumturia	Planifikimi
Dhembshuria	Që shikon përpara	Loja
Kompetenca	Ritmi	Kënaqësia
Konkurrenca	Liria	Fuqia
Përfundimi	Miqësia	Privatësia
Afiniteti	Argëtimi	Pastërtia
Bashkëpunimi	Mirësia	Cilësia
Qyteti/fshati	Rritja/zhvillimi	Rrezatimi
Kreativiteti	Harmonia	Njohja
Vendosmëria	Shëndeti	Marrëdhëniet me të tjerët
Demokracia	Ndihmues	Feja

Dizajni	Ndihmon shoqërinë	Reputacioni
Zbulimi	Ndershmëria	Përgjegjësia & Përgjegjshmëria
Diversiteti	Humori	Risku
Ndërgjegjësimi mjedisor	Imagjinata	Siguria dhe sigurimi
Siguria ekonomike	Përmirësimi/vlerësimi	Vetë-respekti
Arsimimi	Pavarësia	Ndjeshmëria
Efektiviteti	Ndikimi tek të tjerët	Sensualiteti
Efikasiteti	Harmonia e brendshme	Qetësia
Eleganca	Frymëzimi	Shërbimi
Argëtimi	Integriteti	Seksualiteti
Iluminizmi	Intelekti	Sofistikimi
Barazia	Përfshirja	Shkëndijat
Etika	Njohuritë	Spekulimet
Ekselencia	Lidershipi	Spiritualiteti
Entuziazmi	Të mësuarit	Stabiliteti
	Besnikëria	Statusi
	Madhështia	Suksesi
	Bërja e diferencës	Mësimdhënia
	Mjeshtëria	Butësia
	Puna kuptimplotë	Emocioni
	Kontributi	Uniteti
	Paratë	Shumëllojshmëria
	Parimet morale	Pasuria
	Misteret	
	Natyra	
	Sinqeriteti	

Vlerat e tjera që nuk janë në këtë listë:

---



---



---



---



---



---

5 vlerat më të rëndësishme:

1 \_\_\_\_\_

2 \_\_\_\_\_

3 \_\_\_\_\_

4 \_\_\_\_\_

5 \_\_\_\_\_

### Udhëzime për mësime

- Shpërndani listën e vlerave të nxënësit dhe jepni sqarimet e duhura për plotësim.
- Kërkoni nga nxënësit që ta lexojnë testin e vlerave bazë që thjesht mund ta lexoni dhe të shohin se cilat vlera janë të vërteta për ata.
- Kërkoni nga ata që të përdorin shenja dhe të rrumbullaksojnë për të shënuar vlerat ose, nëse preferoni, përdorni një vlerësim për t'ju ndihmuar të përcaktoni se cilat janë më të rëndësishmet.
- Mos harroni ti informoni nxënësit se asnjë listë nuk mund të jetë kurrë e plotë. Mund të ketë disa vlera personale shtesë që janë unike për ju, prandaj mos u kufizoni nga lista. Kërkoni nga ata që të shtojnë çdo gjë tjetër që ju duket e drejtë.
- Kërkoni nga nxënësit që ta bëjnë në fund një listë prej 5 vlerave më të rëndësishme për ata.
- Pasi ta kenë përfunduar testin, nxënësit ndahen në çifte dhe i ndajnë vlerat e tyre me shokun/shoqen.
- Në fund kërkohet nëse ka vullnetarë për ti ndarë vlerat e tyre në klasë.

## 1.3 Testi i karakteristikave personale

### Ushtrimi 1: Ushtrimi me 5 karakteristikat personale

Secili person ka karakteristika specifike që i bënë unik – dhe veçanërisht të përshtatshëm për punë të caktuara. Identifikimi i karakteristikave tuaja personale do ta bëjë shumë më të lehtë për ju të kuptoni veten tuaj dhe atë që do bëni në jetën dhe punën tuaj.

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- reflektojnë dhe identifikojnë karakteristikat personale të tyre për ti marrë parasysh kur bëjnë zgjedhjen e profesionit.

Këtu janë disa shembuj të karakteristikave personale. Rrethoni ato që ju përshkruajnë. Nëse disa karakteristika të rëndësishme mungojnë, shkruajini ato në fletën me poshtë.

I/e saktë	Kurioz	Intuitiv	Realist
Praktik	I/e vendosur	I/e gëzuar	Reflektues/i menduar
Ambicioz	I/e disiplinuar	Besnik	I/e rezervuar/turpshëm
I/e pëlqyeshëm	Diskret	Metodik	Me respekt
I/e vëmendshëm	Dinamik	I/e kujdesshëm	Përgjegjës
I/e pavarur	Emocional	Optimist	Përfytyrues
Inovativ	Energjik/entuziast	I/e organizuar	I/e ndjeshëm
Aventurier	I/e besueshm	Origjinal	Serioz
Këmbëngulës	Kërkues	Hapur	E dobishme
I/e qetë	Shprehës	I/e pasionuar	I/e shoqërueshëm
Holistik	Sipërmarrës	Këmbëngulës	Analitik
Konkurrues	Fleksibil	Perceptues	Spontane
I/e sigurt	Bujar	Perfeksionist	Tifozë
Bindës	I/e sinqertë	I/e durueshëm	Tolerant
I/e guximshëm	Inovativ	Pozitiv	Trim
Krijues	I/e nderuar	Praktik	
Kritik	Me takt		

Karakteristikat e tjera personale që nuk janë në këtë listë:

---

---

---

---

---

---

---

5 Karakteristikat më të rëndësishme personale:

- 1 \_\_\_\_\_
- 2 \_\_\_\_\_
- 3 \_\_\_\_\_
- 4 \_\_\_\_\_
- 5 \_\_\_\_\_

### Udhëzime për mësuesin

- Shpërndani listën e karakteristikave personale dhe jepni sqarimet e duhura për plotësim.
- Kërkoni nga nxënësit që ta lexojnë testin e karakteristikave personale bazë që të mund ta shohin dhe ta kuptojnë atë.
- Kërkoni nga ata që të përdorin shenja dhe të rrumbullaksojnë për të shënuar karakteristikat personale për t'iu ndihmuar të përcaktoni se cilat janë më të rëndësishmet.
- Mos harroni ti informoni nxënësit se asnjë listë nuk mund të jetë kurrë e plotë. Mund të ketë disa karakteristika personale shtesë që janë unike për ju, prandaj mos u kufizoni në listë. Kërkoni nga ata që të shënojnë çdo gjë tjetër që ju duket e drejtë.
- Kërkoni nga nxënësit që ata në fund të kenë një listë prej 5 karakteristikave personale më të rëndësishme për ata.
- Pasi ta kenë përfunduar nxënësit testin ndahen në çifte dhe i ndajnë karakteristika e tyre personale me shokun/shoqen.
- Në fund kërkohet nëse ka nxënës vullnetarë për t'i ndarë karakteristika personale e tyre në klasë.

## 1.4 Testi i interesave

Gjërat që ju pëlqejnë t'i bëni mund të iu japin juve ide për llojin e punës në të cilën do të ishit të mirë.

A e dini fushën e punës që mund t'iu interesojnë?

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë gjërat që ju pëlqejnë ti bëjnë që mund të iu japin atyre ide për llojin e punës në të cilën do të ishin të mirë.

### Kuizi- Interesat

Këtu është paraqitur një kuiz që mund t'iu ndihmojë të zgjedhni interesat tuaja. Përgjigjuni me "Po" ose "Jo" në formulimet/fjalitë:

	PO	JO
1 Preferoj të merrem me diçka tjetër, sesa të lexoj një libër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2 Më pëlqejnë lojërat për zgjidhjen e problemeve dhe gjëagjzave.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3 Më pëlqen të ndihmoj të tjerët kur ata kanë nevojë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4 Më pëlqen të lexoj dhe të mësoj për tema të reja.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5 Më pëlqen të punoj me duar.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6 Më pëlqen të jem lider në një grup njerëzish.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7 Preferoj të di të gjitha faktet përpara se të trajtoj një problem.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8 Më pëlqen të kujdesem për njerëzit e tjerë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9 Më pëlqen të dizajnoj, shpik ose krijoj gjëra.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10 Më pëlqen të shpreh veten përmes artit, muzikës ose shkrimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11 Do të doja një punë në të cilën mund të merrem me njerëz gjatë gjithë ditës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12 Më pëlqen të punoj me materiale dhe pajisje.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13 Më pëlqen të mësoj fakte dhe ide të reja.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14 Mendoj se bashkëpunimi me njerëzit e tjerë më vjen natyrshëm.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

15	Më pëlqen të zbuloj se si funksionojnë gjërat duke i çmontuar ato.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16	Më mirë do të punoja me makina dhe gjëra, sesa me njerëz.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17	Zakonisht mund t'i bind njerëzit që t'i bëjnë gjërat sipas mënyrës sime.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18	Më pëlqen të ndërtoj dhe riparoj gjëra.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19	Më pëlqen pjesa kërkimore e projekteve të mia.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20	Më pëlqen të jem me njerëz.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
21	Më pëlqen të mendoj ide dhe mënyra të ndryshme për të bërë gjëra.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
22	Më pëlqen të dëgjoj mendimet e njerëzve të tjerë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
23	Më pëlqen të mësoj se si të përdor mjete të ndryshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
24	E kam të lehtë të ndjek udhëzimet e shkruara.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Për të zbuluar fushat e punës që mund t'ju interesojnë, krahasoni përgjigjet tuaja me numrat e grupeve në vijim.**

### PËRGJIGJET E KUZIT

Numrat 1, 5, 9, 12, 15, 16, 18, 23.

Nëse i jeni përgjigjur “Po” shumicës prej këtyre numrave, ju me siguri jeni person praktik që pëlqeni të punoni me “**GJËRAT/SENDET**”. Ju pëlqen të punoni me vegla dhe makina, të bëni gjërat me duart tuaja, rregulloni dhe mirëmbani pajisje ose zbuloni se si funksionojnë gjërat. Punët që juve mund të ju pëlqejnë janë në inxhinieri, prodhimi i produkteve, ndërtimi, riparimi dhe servisimi, transporti, tregtia dhe teknologjia.

Numrat 2, 4, 7, 10, 13, 19, 21, 24.

Nëse jeni përgjigjur me “Po” shumicën prej kyre numrave, ju ndoshta jeni person i “**INFORMATAVE**”. Ju pëlqen të shprehni

përmes shkrimit, muzikes ose artit, kryeni eksperimente ose hulumtoni, zgjidhni enigma dhe probleme, ose studioni dhe lexoni. Punët që kanë të bëjnë me informacionin gjenden në art dhe argëtim, biznes dhe financa, kërkime shkencore, shitje dhe shërbime, turizëm, drejtësi dhe qeveri.

Numrat 3, 6, 8, 11, 14, 17, 20, 22.

Nëse jeni përgjigjur me “Po” shumicës prej tyre numrave, ju ndoshta jeni një person që pëlqeni “**NJERËZIT**”. Ju pëlqen të kujdeseni dhe të ndihmoni të tjerët, inkurajoni njerëzit, punoni si pjesë e një ekipi dhe udhëheqni dhe mbikëqyrni të tjerët. Punët që kanë të bëjnë me njerëzit janë në kujdesin shëndetësor, arsim dhe trajnim, punë sociale dhe këshillim, dhe feja.

Nëse i përgjigjeni “Po” numrave nga secili grup, mund të tregojë se nuk i keni të qarta preferencat për një lloj pune të caktuar. Ju mund të jeni i përshtatshëm për një punë që është kombinim i disa prej këtyre interesave.

### Udhëzime për mësime të përgjigjes

- Aktiviteti në fillim bëhet në mënyrë individuale duke shpërndarë fletën e kuzit të interesave tek secili nxënës.
- Kërkoni që nxënësit të përgjigjen në pyetjet e kuizit për 15 minuta.
- Pas 15 minutash ndani nxënësit në grupe të vogla dhe kërkoni që ata të ndajnë përgjigjet e tyre.
- Në fund kërkoni që çdo grup të prezantojë interesat e tyre.
- Kërkoni që nxënësit të vendosin në listë (profili personal) 5 interesat e tyre.

**Kërkoni nga nxënësit që të plotësohet lista e profilit personal gjatë ushtrimeve të mësipërme si dhe të ruhet dhe lexohet herë pas herë nga nxënësit për t'iu përkujtuar atyre se cilat janë 5 aftësitë, vlerat, karakteristikat personale dhe interesat.**

### Profili personal

#### Aftësitë e mia kryesore

- ★ Unë jam vërtetë i/e mirë në ...
- ★ Unë jam vërtetë i/e mirë në ...
- ★ Unë jam vërtetë i/e mirë në ...
- ★ Unë jam vërtetë i/e mirë në ...
- ★ Unë jam vërtetë i/e mirë në ...

#### Karakteristikat e mia kryesore

- ✓ Unë jam...
- ✓ Unë jam...
- ✓ Unë jam...
- ✓ Unë jam...
- ✓ Unë jam...

#### Vlerat e mia kryesore

- ♥ Unë vlerësoj...
- ♥ Unë vlerësoj ...
- ♥ Unë vlerësoj ...
- ♥ Unë vlerësoj ...
- ♥ Unë vlerësoj ...

### Interesat e mia kryesore

- ☹ Mua vërtetë më pëlqen...
- ☹ Mua vërtetë më pëlqen ...
- ☹ Mua vërtetë më pëlqen...
- ☹ Mua vërtetë më pëlqen...
- ☹ Mua vërtetë më pëlqen...

## 1.5 Idhulli (Heroi) im

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- ndihmojnë pjesëmarrësit të identifikojnë shkathhtësitë dhe cilësitë që janë të rëndësishme për ta dhe që ata i adhurojnë.

Pyetje për nxënësit

Pse janë aftësitë dhe cilësitë e identifikuara aq të rëndësishme për ta.

A është lindur hero i me aftësi dhe cilësi të identifikuara apo është dashur t'i mësojnë/ zhvillojnë disa nga ato aftësi/cilësi.

A kanë ndonjë nga këto aftësi dhe cilësi hero i tyre i zgjedhur.

### Udhëzime për mësime të përgjigjes

- Kërkoni nga nxënësit që të vizatojnë ose shkruajnë një përshkrim të shkurtër për ndonjë njeri që ata e adhurojnë ose heroin/ heroinën.
- Kërkoni nga ta që të tregojnë për çka ata e adhurojnë atë person - aftësitë, cilësitë etj.
- Kërkoni nga pjesëmarrësit që t'i ndajnë pikëpamjet e tyre me pjesën tjetër të grupit.



## 1.6 Një letër për vetën time

Objektivi mësimor:

- Nxënësit do të planifikojnë qëllimet e ardhshme përmes shkrimit vetë-reflektues.

Materialet e nevojshme:

- Fletorja për të shkruar “**Letër për vetën time**” (duhen kopje e shtypur që i shërben portofolit)
- Shembuj të letrës për veten time (nuk përfshihen)

### LETËR VETES

**Përshkrimi i detyrës:** Shkruani një letër vetes se si do të jetë jeta juaj pas katër vjetësh.

I referoheni aktiviteteve që keni përfunduar më herët për t’ju ndihmuar të organizoni mendimet tuaja.

Formati për të shkruar letrën tuaj:

**Paragrafët 1 dhe 2:** Përshkruani si është jeta juaj pas katër vjetësh.

- Punon?
- Apo shkoni në shkollë?
- Ku jetoni?
- Çfarë ju pëlqen në jetën tuaj?

**Paragrafët 3, 4 dhe 5:** Çfarë pengesash keni hasur për të arritur këtu ku jeni sot?

- Si u përpoqët t’i kapërceni ato barrierat?
- Sa i suksesshëm keni qenë?
- Çfarë zbuluat gjatë rrugëtimit që ju ka ndihmuar?

**Paragrafët 6 dhe 7:** Çfarë keni mësuar këtë vit për të punuar drejt qëllimeve tuaja?

- Çfarë këshille do t’i jepnit një nxënësi në të njëjtën klasë me ju?
- Cilat janë shpresat tuaja për të ardhmen?

### Udhëzime për mësime

- Shpërndajuni nxënësve fletët për “Shkrimin e letrës sime”.
- Udhëzoni nxënësit të shikojnë me kujdes fletoren e tyre përpara se të shkruajnë letrat e tyre.
- Sygjeroni tek nxënësit se ata duhet të reflektojnë dhe shkruajnë mbi pikat e forta, qëllimet dhe vizionin e tyre për atë që duan të bëhen.
- Kërkoni nga nxënësit që letrat të ruhen për një periudhë kohe. Letrat duhet të hapet dhe lexohet pas një periudhe kohore.

## 1.7 Stilet e të mësuarit

Stili i të mësuarit është mënyra se si individët përqëndrohen, absorbojnë dhe kujtojnë informacione të reja dhe të vështira për tu mbajtur mend ose shkathtësi të reja. Stili i të mësuarit përfshin një kombinim të elementeve mjedisore, emocionale, sociologjike, fizike dhe psikologjike që i lejojnë individët të marrin, ruajnë dhe përdorin njohuritë ose aftësitë.

Çdo nxënës ka një stil unik të të mësuarit. Sipas Jody Ehelden, një psikoterapiste, këshilltare dhe mësuese, “Çdo stil i të mësuarit është si një instrument në një orkestër. Nxënësit duhet të dinë se cili instrument është i tyre dhe si përshtaten në orkestër.”

Çdo nxënës mëson ndryshe, me një ritëm të ndryshëm, duke përdorur stile të ndryshme të të mësuarit. Të gjithë kanë një stil të të mësuarit. Stili ynë i të mësuarit, nëse përshtatet, mund të rezultojë në përmirësimin e qëndrimeve ndaj të mësuarit dhe një ngritje të arritjeve akademike. Duke identifikuar stilin tuaj të të mësuarit, ju do të identifikoni se si mësoni më mire. Stilet e të mësuarit nuk pasqyrojnë nivelet e arritjeve

apo aftësive akademike. Asnjë stil nuk është më i mirë se tjetri.

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- reflektojnë për mënyrën e tyre të të mësuarit
- përcaktojnë stilin e tyre të të mësuarit
- identifikojnë se si mësojnë më së miri
- përdorin strategji personale të të mësuarit

### Lista/ inventari i stilit të të mësuarit<sup>2</sup>

**Udhëzime:** Rrethoni shkronjën përpara definicionit në fjali që ju përshkruan më mirë.

- 1 Nëse më duhet të mësoj se si të bëj diçka, mësoj më mirë kur:
  - P. Shikoj dikë të më tregojë se si ta bëj atë.
  - D. Dëgjoj dikë që më thotë se si ta bëj atë.
  - SH. Mundohem ta bëj vetë.
- 2 Kur lexoj, shpesh zbuloj se:
  - P. Vizualizoj atë që po lexoj në mendjen time.
  - D. Lexojë me zë të lartë ose dëgjoj fjalët në kokën time.
  - SH. Nuk më zë vendi-vend dhe përpiqem të “ndjej” përmbajtjen.
- 3 Kur më kërkohet të jap udhëzime, unë:
  - P. Shikoj vendin e caktuar në mendjen time derisa i them ose preferoj t’i vizatoj.
  - D. Nuk e kam të vështirë t’i them me gojë.
  - SH. Duhet të tregoj ose të lëviz trupin tim derisa jap diçka.
- 4 Nëse nuk jam i sigurt se si:
  - P. Shkruaj së pari për të përcaktuar nëse duket e drejtë.
  - D. E them me zë të lartë për të përcaktuar nëse tingëllon e drejtë.
  - SH. E shkruaj së pari për të përcaktuar nëse ndihem në rregull.
- 5 Kur shkruaj unë:
  - P. Jam i shqetësuar se sa të rregullta dhe të strukturuar duken shkronjat dhe fjalët e mia.
  - D. Shpesh i them shkronjat dhe fjalët me vete.
  - SH. Shtrëngoj fort lapsin që të ndiejë rrjedhën e fjalëve.
- 6 Nëse do të më duhet të mbajë mend një listë artikujsh, do ta mbaja mend më mirë nëse:
  - P. E shkruaj atë.
  - D. I përsërisë vazhdimisht me vete.
  - SH. Lëviz nga vendi dhe përdor gishtat për të emërtuar çdo artikull.
- 7 Unë preferoj mësimdhënësit të cilët:
  - P. Përdorin dërrasën e zezë ose projektor derisa ata ligjërojnë.
  - D. Përdorin shumë shprehje.
  - SH. Përdorin aktivitete praktike
- 8 Kur përpiqem të përqendrohem, e kam të vështirë kur:
  - P. Ka shumë rrëmujë ose lëvizje në dhomë.
  - D. Ka shumë zhurmë në dhomë.
  - SH. Më duhet të rri pa lëvizur për një kohë të gjatë.
- 9 Kur zgjidh një problem unë:
  - P. Shkruaj ose vizatoj diagrame për ta parë atë.
  - D. Përsërisë në vete.
  - SH. Përdor të gjithë trupin tim ose lëvizi ndonjë objekt për të më ndihmuar të mendoj.
- 10 Kur më jepen udhëzime me shkrim se si të ndërtohet diçka, unë:
  - P. Lexoj ato në heshtje dhe përpiqem të imagjinoj se si do të përshtaten pjesët së bashku.
  - D. Lexoj ato me zë të lartë dhe flas me veten ndërsa bashkoj pjesët.
  - SH. Mundohem së pari ti bashkoj pjesët dhe më vonë lexoj.

<sup>2</sup> Përshtatur nga, Learning to Study Through Critical Thinking, J.A. Beatrice

- 11 Gjatë pritjes për të mbajtur veten të zënë, unë:  
P. Shikoj përreth, vështroj ose lexoj.  
D. Flasë ose dëgjoj të tjerët.  
SH. Eci, manipuloj gjërat me duar ose lëviz/dridh këmbët e mia ndërsa jam ulur.
- 12 Nëse do të më duhej t'i përshkruaja me gojë diçka një personi tjetër, do ta bëja:  
P. Jam i shkurtër, sepse nuk më pëlqen të flas gjatë.  
D. Flasë në detaje sepse më pëlqen të flas.  
SH. Flasë me gjeste dhe lëvizi duke folur.
- 13 Nëse dikush do t'i përshkruante me gojë diçka një personi tjetër, unë do të:  
P. Përpiqem të përfytyroj atë që ai/ajo po thoshte.  
D. Më pëlqen të dëgjoj, por dua të ndërpres dhe të flas vetë.  
SH. Mërzitem nëse përshkrimi i saj/i tij është shumë i gjatë dhe i detajuar.
- 14 Kur përpiqem të kujtoj emrat, më kujtohen:  
P. Fytyrat, por harrojë emrat.  
K. Emrat, por harrojë fytyrat.  
SH. Ngjarjen ku e kam takuar personin dhe jo emrin ose fytyrën e personit.

Karakteristikat e tjera personale që nuk janë në këtë listë:

---



---



---

**Udhëzime për vlerësimin e pikëve:** Shtoni numrin e përgjigjeve për secilën shkronjë dhe vendosni totalin më poshtë. Fusha me numrin më të madh të përgjigjeve është mënyra juaj kryesore e të mësuarit.

---

Pamore/Vizuale

---

Dëgjimore/Auditor

---

Shqisore/Kinestetike

**Përshkrimi i stileve të mësuarit****NXËNËSIT PAMOR/ VIZUAL**

- Organizojnë hapësirën e punës dhe të jetesës për të shmangur shpërqendrimet.
- Ulën në pjesën e përparme të klasës për të shmangur shpërqendrimin dhe larg dyerve ose dritareve ku ndodh veprimi.
- Ulën larg hartave të murit ose tabelave të shpalljeve.
- Përdorin material të organizuar mirë ose të shtypur.
- Përdorin stimulues vizual, imazhe vizuale, përsëritje me shkrim, karta dhe strategji të grupimit për të përmirësuar memorien.
- Rindërtojnë imazhet në mënyra të ndryshme, provojnë rregullime të ndryshme hapësinore dhe përfitojnë nga hapësirat e zbrazëta që mbetën në faqe.
- Përdorin bllok shënimesh, postimet, lista të detyrave dhe forma të tjera rikujtuese.
- Përdorin skicimin e formatit për regjistrimin e shënimeve. Përdorin nënvizimin, theksimin me ngjyra të ndryshme, simbole, grafikë ose fotografite në shënimet e tyre.
- Praktikojnë kthimin e shenjave vizuale në fjalë ndërsa përgatiteni për provime.
- Lejojnë kohë të mjaftueshme për planifikimin dhe regjistrimin e mendimeve gjatë kryerjes së detyrave për zgjidhjen e problemeve.
- Përdorin strategji të përgatitjes së testit që theksojnë organizimin e informacionit, kodimin dhe rikujtimin vizual.
- Marrin pjesë aktive në aktivitetet e klasës ose grupit.
- Zhvillojnë skica të përgjigjeve me shkrim ose me pikturë përpara se t'u përgjigjen pyetjeve të esesë.

**NXËNËSIT DËGJIMOR/ AUDITOR**

- Punon në hapësira të qeta për të reduktuar shpërqendrimet, duke shmangur hapësira me biseda, muzikë dhe televizor
- Ulen larg dyerve ose dritareve ku zhurmat mund të depërtojnë në klasë

- Përsërisin informacionin me gojë
- Marrin pjesë rregullisht në ligjëрата
- Diskutojnë tema me nxënës të tjerë, mësimdhënës. Ju kërkojnë të tjerëve të dëgjojnë së qysh ata e kanë kuptuar materialin
- Përdorni rima, tingëllime dhe përsëritje, dëgjojnë regjistrimet në kasetë për të përmirësuar kujtesën
- Praktikojnë ndërveprimin verbal për të përmirësuar motivimin dhe vetë-monitorimin
- Përdorin magnetofon për të dokumentuar ligjëрата dhe për materialet e leximit
- Mbajnë në mendje dhe shqyrtojnë ilustrimet në tekstet shkollore për t'i shndërruar ato në përshkrime verbale
- Lexojnë me zë të lartë udhëzimet për testet ose detyrat, ose pyesin dikë t'iu lexojë ato, veçanërisht nëse udhëzimet janë të gjata dhe të ndërlikuara
- I'a kujtojnë vetes të rishikojnë detajet
- Përdorin mjetet për menaxhimin e kohës dhe përkthejnë përkujtuesit me shkrim të takimeve në shenja verbale
- Përdorin stuhi mendimesh verbale dhe shkrime me regjistrim dhe korigjim
- Lejnë hapësira në shënimet e ligjëratës për të rikujtuar me vonë dhe 'paraqitje' të mëvonshme. Zgjerojnë shënimet e tyre duke folur me të tjerët dhe duke mbledhur shënime nga libra të ndryshëm
- Lexojnë shënimet e tyre me zë të lartë
- Praktikojnë të shkruajnë përgjigjet duke përdorur fletore të vjetra dhe duke përsëritur me zë përgjigjet e tyre

**NXËNËSIT SHQISORË/ KINESTETIK**

- Mbajnë fjalim verbal të shkurtër dhe të saktë
- Marrin pjesë aktive në diskutime
- Përdorin të gjitha shqisat-shikimin, prekjën, shijen, nuhatjen, dëgjimin
- Preferojnë përfshirjen e drejtpërdrejtë, manipulimin fizik, imazhet dhe aktivitetet "praktike" për të përmirësuar motivimin,



Emri mbiemri	Pamore	Dëgjimore	Shqisore	Komentet

### Udhëzime për mësime dhënësit:

Çfarë tipi jam në të mësuarit tim?

#### Ecuria:

#### Shembull për metodën: Ndërmarrja me stacione

#### Ndërmarrja me stacione për temën „Të mësuarit“

Në çdo stacion paraqitet një fletë në formatin A4, e cila përmban disa fjalë-impulse: Nxënësit i vizitojnë stacionet në çift dhe shkruajnë përvojat e tyre personale.

Fjalët-impulsi:

- Mendimi për të mësuarin
- Aftësia për të mbajtur mend/kujtesa
- Përqendrimi

- Përgatitja e të mësuarit
- Problemet gjatë të mësuarit
- Materiali mësimor
- Punimet e shkollës
- Frika nga provimet
- Kohëzgjatje e të mësuarit – Pauzat
- Kush ndihmon?
- Këshillat e mia për të mësuarin

Rezultatet prezantohen dhe bëhet diskutim në lidhje me to.

#### Shembull për metodën: Punë në grupe

Çfarë tipi jam unë për të mësuar?

Në një fletë pune nxënësve u paraqiten disa fjalë (që merren nga përshkrimi i stileve të mësuarit). Nxënësit shënojnë ato fjalë, për të cilat ata spontanisht mendojnë se janë të përshtatshme.

Fjalët nga grupi 1 i referohen tipit Dëgjimor/  
Auditor

Fjalët nga grupi 2 i referohen tipit Pamor/  
Vizual

Fjalët nga grupi 3 i referohen tipit Shqisor/  
Kinestetik

Në rast se kemi të njëjtën shpërndarje në të tre grupet, atëherë bëhet fjalë për një tip të përzier. Është gjithashtu e mundur, që të lexohen përkatësisht 10 fjalë/sendë (p.sh. mollë, biçikletë, fletore, unazë, zar, etj.) (tipi me dëgjim), t'i lexojnë nxënësit (tipi vizual) dhe t'i tregojnë nxënësit (tipi kinestetik).

(Kujdes: Duhet të ketë tre grupe kryesore fjalësh, përndryshe del në pah edhe një efekt mësimor.) Ajo metodë, nëpërmjet së cilës arrihen rezultatet më të mira, përcakton tipin e të mësuarit.

### **Puna në grup 2:**

Nxënësit formojnë grupe homogjene në varësi të tipit të të mësuarit dhe shkruajnë

këshilla, të cilat janë një ndihmë e madhe për tipin e tyre:

p.sh.:

#### Tipi akustik:

Materiali të lexohet me zë të lartë dhe materiali i mësuar të thuhet me zë të lartë.

Materiali i mësuar të regjistrohet në telefon (mjete tjera digjitale) dhe të dëgjohet shpesh. Të bëhen pyetje gjatë orës së mësimit.

Diskutoni gjatë kontrollimit të detyrave të shtëpisë.

Përsëriteni në çift materialin e mësuar me zë të lartë dhe pyeteni njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellët.

#### Tipi vizual:

Materiali që duhet mësuar të plotësohet me skica dhe grafikone.

Të hartohen pano për materialin që duhet mësuar.

Në fletore ose fletë pune të realizohen figura me domethënie buzëqeshëse.

Gjërat më të rëndësishme të shënohen me markera me ngjyra.

Nocione të rëndësishme, të cilët nuk mund të mbahen mend me lehtësi, të shkruhen në fleta ose në kartela dhe të vendosen në vende të tilla, që të mund të shihen shpesh.

Të përdoren figura të detajuara ose jo të detajuara. Të hartohen Mindmaps (hartat mendimesh).

#### Tipi motorik:

Materiali që duhet mësuar të shkruhet edhe njëherë gjatë kohës që mësohet (p.sh. fjalë).

Lëvizni mjaftueshëm: p.sh. lëvizni në formë rrethore dhe tekstet që duhen mësuar thuani me zë të lartë.

Fjalët transformojini në lëvizje dhe shkruajini me dorë në ajër.

Mësoj duke dalë në shëtitje.

E rëndësishme:

- Sa më shumë rrugë të keni përdorur për të mësuar, aq më mirë mbahet mend materiali që duhet mësuar.
- Këto këshilla prezantohen nga grupet dhe plotësohen nga nxënësit e tjerë apo edhe nga mësimdhënësi.
- Këshillat përkatëse shkruhen në pllakatë/pano/poster.
- Strategjitë më të rëndësishme të të mësuarit shkruhen të përmbledhura në një fletë pune (shiko shabllonin 3 për fotokopje).

P.sh. filloni të mësoni në kohën e duhur, ndani në pjesë materialin që duhet të mësoni – pjesë të vogla për të mësuar (përgatitni listë), bëni planifikim të saktë ditor dhe javor (Çfarë duhet të bëj dhe kur?), përforsim dhe përsëritje (p.sh para se të bini për të fjetur), bëni pushime, forma e shkrimit, kalendar për nxënësit me të gjitha datat e provimeve, testimet dhe punimet që duhen dorëzuar në shkollë, shmangni tërheqjen e vëmendjes (muzikë, lodra, motra e vëllezër, etj.), pini ujë etj.

## 1.8. Pengesat për suksesin tim

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- ju mundësohet nxënëseve t'i identifikojnë pengesat për përparim dhe diskutojnë nëse këto pengesa janë të tejkalueshme, nëse po si mund të tejkalohen.

**Aktiviteti** (puna në grupe me nga 4 ose 5 nxënës)  
 Pyetjet për nxënësit

- A janë pengesat e tejkalueshme apo jo?

- Përgjegjësi e kujt është për t'i tejkaluar pengesat?
- A ka ndonjë agjenci ose individ të cilët mund të jenë në gjendje të ndihmojnë për tejkalimin e pengesave të caktuara?

Ushtimin që do ta bëni do të ju ndihmojë të mendoni për pengesat që ndikojnë te ju dhe ju kërcënojnë që të jeni të suksesshëm, ashtu siç ju shpresoni.

Shkruani pesë pengesat më të mëdha që ju i keni identifikuar.

- 1 \_\_\_\_\_
- 2 \_\_\_\_\_
- 3 \_\_\_\_\_
- 4 \_\_\_\_\_
- 5 \_\_\_\_\_

Cilat nga këto i keni nën kontroll?

- 1 \_\_\_\_\_
- 2 \_\_\_\_\_
- 3 \_\_\_\_\_
- 4 \_\_\_\_\_
- 5 \_\_\_\_\_

Cilat nga këto nuk i keni nën kontroll?

- 1 \_\_\_\_\_
- 2 \_\_\_\_\_
- 3 \_\_\_\_\_
- 4 \_\_\_\_\_
- 5 \_\_\_\_\_



1 NUK KAM DIPLOMËN E NEVOJSHME	2 NUK E DI SE ÇFARË DO TË BËJ
3 NUK KAM IMAZHIN E DUHUR	4 SITUATA IME PËR BANIM
5 KAM PROBLEM TË NGRITEM NGA SHTRATI	6 JAM SHUMË I RI PËR TË BËRË ATË QË DUA
7 MË TEPËR DO TË HUMBI FINANCIAR-ISHT ME KËTË PUNË SE SA QË FITOJ	8 SHOKËT E MI JANË DUKE MË BLOKUAR
9 NUK JAM I MIRË NË KRIJIMIN E MARRËDHËNIEVE ME TË TJERËT	10 NDIHEM SHUMË I LODHUR TË SHUMTËN E KOHËS
11 NUK E DI NË ÇKA JAM I MIRË	12 MËNYRA SE SI UNË PËRDORI ILAÇET
13 NUK PËLQEJ PËRDORIMIN E TELEFONIT	14 JAM SHUMË I ZËNË TË PUNOJ PUNË QË NUK PAGUHET
15 NUK KAM PARA TË MJAFTUESHME	16 NUK KAM ASNJË PALË RROBE SERIOZE

17

QËNDRIMET E NJERËZVE  
PËR GJININË

18

NUK DI SI TA PLOTËSOJ  
FORMULARIN

19

QËNDRIMET E NJERËZVE  
PËR RACAT

20

UNË KAM FAMË TË  
KEQE

21

VENDI NË TË CILIN  
JETOJ KA REPUTACION TË KEQ

22

RELIGJIONI  
IM

23

NJERËZIT MË  
INJOROJNË

24

UNË DORËZOHEM  
SHUMË LEHTË

25

JAM SHUMË I GJATË/I SHKURTËR/  
I PLOTË/I DOBËT

26

NUK MUND TA KONTROLLOJ  
TEMPERAMENTIN TIM

27

KAM ANGAZHIME TË  
MËDHA NË FAMILJE

28

NUK KAM ASKËND  
TË MË NDIHMOJË

29

NUK DËSHIROJ TË  
RREZIKOJ

30

SHKRIMI DHE LEXIMI IM  
NUK JANË MJAFT TË MIRË

31

KAM DOSJE  
KRIMINALE

32

NUK KAM BESIM TË  
MJAFTUESHËM NË VETVETE

<p>33</p> <p>SHËNDETI IM MË FRENON</p>	<p>34</p> <p>JAM DISLEKSIK</p>
<p>35</p> <p>NUK KAM ASNJË NJERI QË MË PERKRAH</p>	<p>36</p> <p>JAM DEMBEL</p>
<p>37</p> <p>NUK JAM I MIRË NË MATEMATIKË</p>	

#### Udhëzime për mësime dhënësit

- Shpërndaj letrat për pengesat e suksesit tek secilin grup; përfshij disa letra të bardha, kështu që nxënësit të jenë në gjendje për të shtuar disa pengesa të cilat nuk janë të përfshira.
- Çdo nxënës identifikon këto pengesa të cilat ata mendojnë që i parandalojnë ata për të bërë përparim dhe kërkoni nga ata të shënojnë pesë më të rëndësishmet në fletat e tyre të punës.
- Kërkoni nga nxënësit që të identifikojnë këto pengesa të cilat ata mendojnë që janë në kontrollin e tyre/ose nuk janë në kontrollin e tyre dhe shënoni ato në fletët e punës.
- Inkurajoni grupin për të diskutuar çështjet të cilat kanë dalë në shesh, veçanërisht në lidhje me atë se çka mund të bëhet për t'i tejkaluar këto pengesa

## 1.9. Kodet e personalitetit-Testi Holland

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- identifikojnë kodin e personalitetit dhe të shkruajnë llojin e tyre personal RHASNT me tre shkronja.

### Puna në grup

Nxënësit i përgjigjen pyetjes “Si do ta përshkruanit personalitetin tuaj?” pastaj lexojnë të gjitha llojet e personalitetit sipas Testit Holland dhe mund të mbajnë shënime, të shkruajnë fjalitë në tekst me të cilat mund të kenë nevojë për ndihmë, ose të vizatojnë imazhe që duan t’i lidhin me atë lloj personaliteti.

Nxënësit mund të mbajnë shënime, të shkruajnë fjalët që nuk i kuptojnë të cilat mund të kenë nevojë për ndihmë, ose të vizatojnë imazhe që duan t’i lidhin me atë lloj personaliteti.

### Puna në grupe të vogla

Përshkrimi i llojeve të personalitetit:

Ndani nxënësit në 6 grupe të vogla dhe caktoni secilin nga llojet e personalitetit.

Secili grup do të lexojë përkufizimin e tipit të caktuar dhe do të krijojë në mënyrë krijuese një pamje vizuale, duke përdorur poster ose fletore, që mund të përdoret për të mësuar dhe përfaqësuar atë lloj personaliteti.

### Prezantimi në grup:

Nxënësit duhet të vizatojnë modelin RHASNT nga prezantimi (gjashtëkëndëshi me kodet e personalitetit me poshtë) në fletoren e tyre personale.

Prezantimet: Secili grup ka 1-2 minuta për të paraqitur posterin e tij në klasë dhe për të prezantuar llojin e personalitetit.

### Punë individuale

Nxënësit reflektojnë dhe shkruajnë në mënyrë të pavarur:

Cili është lloji i parë i personalitetit që ndihem se jam unë? Cili është i dyti që më ngjan mua?


### Reflektim/ Përmbledhje (gjithë grupi)

Nxënësit tani bëjnë testin Holland (i cili mund gjindet edhe në versionin online në Busulla.com, që do të identifikojnë dhe shkruajnë llojin e tyre personal RHASNT me tre shkronja.

Fjalja duhet të jetë si në vijim: “Unë e shoh vetën si një \_\_\_\_\_ sepse më pëlqen të \_\_\_\_\_.”

**Detyrë shtëpie:** Nxënësit do të intervistojnë një anëtar të familjes dhe do të bëjnë dy pyetjet që ata zhvilluan më herët për të zbuluar kodin e tyre RHASNT.

Çfarë nënkuptojnë kodet e personalitetit nga testi Holland-RHASNT:



- **R=Realistik** (njeri praktik/dinamik) dëshiron të bëjë gjera praktike dhe jo teorike. Preferon të punojë me shumë me GJËRA, sesa me ide apo njerëz.
- **H=Hulumtues** (Mendimtarë) Intelektual, analitik, logjik. Preferon të punojë në zgjidhjen e problemeve, kryen eksperimente dhe merret me kërkime.
- **A=Artistik** (Krijues) Kreativ, intuitiv, jo konform (nuk janë si të gjithë), inovativ. Preferojnë mjedis të pa strukturuar/mungesë rregullash dhe merren me KREATIVITET dhe IDE.
- **S=Social** (Ndihmues) Të orientuar për të shërbyer, mësimdhënës, ndihmës, koordinojnë dhe bashkëpunojnë. Preferojnë të punojnë me NJERËZ.
- **N=Ndërmarrës** (bindës) Dominues, bindës dhe motivues. Preferon të folurit në publik/udhëheqje dhe aventurë/rrezik/status.
- **T=Tradicional** (Organizues) Efiçient, i/e organizuar dhe i/e orientuar në detaje. Preferon të jetë i saktë dhe korrekt në mjedis pune me STRUKTURË dhe RREGULLA.

**Udhëzime për mësime të mësimdhënësve**

- Ky test u zhvillua nga psikologu amerikan John Holland. Këto gjashtë lloje të personalitetit të bazuara në interes nuk duhet të konsiderohen tipare të personalitetit pasi fjala tipar nënkupton karakteristika të qëndrueshme të personalitetit më pak mundësi ndryshimi, ndërsa lloji pasqyron më saktë përshkrimet e mundshme të interesave të nxënësve.
- Për të mësuar më shumë rreth RHASNT, nxënësit fillimisht do të eksplorojnë përkufizimet e tyre për këtë test, para se të bëjnë testin online.
- Nxënësit të përfshijnë sinonime, imazhe të lidhura ose që tregojnë sjellje që lidhen me atë tip personaliteti dhe një përshkrim të atij tipi.
- Sigurohuni që nxënësit të kenë hapësirë në gjashtë katrorët e tyre për të shkruar përkufizime ose fjalë, ndërsa ata mësojnë për llojet e tjera të personalitetit.
- Këto janë dy mënyra të ndryshme në të cilat nxënësit mund të ndajnë atë çka kanë mësuar në grupin e tyre të vogël dhe të angazhohen me bashkëmoshatarët e tyre për të mësuar duke bashkëpunuar si grup. Zgjidhni opsionin që është më i miri për atë grup nxënësish.
- Nxënësit të udhëzohen të reflektojnë/shkruajnë në portofolin e tyre personal.

**Njih llojin e personalitetit tënd duke përdorur Kodin Holland**

Një nga mënyrat që do të zgjedhësh për të eksploruar karrierën është të vëzhgosh profesionet sipas interesimit që keni për profesionin tuaj. Holland ka bërë një hulumtim që i ndan nxënësit/punëkërkuarit në gjashtë kategori të përgjithshme të personalitetit: • Realistë • Artistikë • Ndërmarrës • Hulumtues • Socialë • Tradicionalë.

Të gjitha llojet kanë cilësi pozitive dhe negative dhe asnjëri lloj nuk është më i mirë se të tjerët. Kodi Holland është një përgjithësim dhe nuk do të thotë se është përcaktimi i saktë. Ky pyetësor i përmbledhur nuk synon të jetë i saktë apo gjithëpërfshirës sikur të jetë instrument i plotë. Plotësimi i këtij pyetësori mund t'ju ndihmojë të identifikoni grupin (grupet) e profesioneve ku keni më shumë interes dhe që ju sjellin më së shumti kënaqësi dhe ju vetëdijësonë për drejtimin në të cilin duhet të hulumtoni për karrierën tuaj.

**Hapi Një:** Rrethoni numrin e të gjithë titujve të mëposhtëm që ju përshtatet më shumë- pjesën tjetër lëreni të paprekur.

- |                                      |                                       |
|--------------------------------------|---------------------------------------|
| 1 Mbjellje dhe kultivim i bimëve     | 25 Të vozisësh kamion                 |
| 2 Zgjidhja e problemeve matematikore | 26 Të punosh në laborator             |
| 3 Të jesh pjesë e një drame          | 27 Të luash instrument muzikor        |
| 4 Të studiosh kultura të tjera       | 28 Të gjesh miq të rinj               |
| 5 Të flasësh me njerëz nëpër festa   | 29 Të udhëheqësh një grup             |
| 6 Të punosh me kompjuterë            | 30 Të përcjellësh buxhetin            |
| 7 Të punosh me makina, kositëse bari | 31 Të rregullosh pajisje elektrike    |
| 8 Astronomia                         | 32 Të dizajnosh plane për ndërtesa    |
| 9 Vizatimi ose piktura               | 33 Të shkruash tregime ose poezi      |
| 10 Të shkosh në xhami/kishë          | 34 Të ndjekësh ngjarje sportive       |
| 11 Të punosh si shitës në panairë    | 35 Të thuash opinionet e tua          |
| 12 Të përdorësh arkën/kasën          | 36 Të përdorësh makineri biznesi      |
| 13 Zdrukthëtaria                     | 37 Të ndërtosh gjëra                  |
| 14 Fizika                            | 38 Të bësh fjalëkryqe                 |
| 15 Gjuhët e huaja                    | 39 Dizajni i modës                    |
| 16 Të punosh me të rinjtë            | 40 Të jesh pjesë e një klubi          |
| 17 Të blesh veshje për shitore       | 41 Të mbash fjalime                   |
| 18 Të punosh me orarin prej 9-5      | 42 Të mbash shënime të detajuara      |
| 19 Të punosh në shtypshkronjë        | 43 Biologjia e natyrës                |
| 20 Të përdorësh pajisje kimie        | 44 Të gjesh përgjigje përmes shkencës |
| 21 Të lexosh libra ose drama         | 45 Të shkosh në koncerte apo teatër   |
| 22 Të ndihmosh njerëz me probleme    | 46 Të punosh me të moshuar            |
| 23 Të shesësh sigurim të jetës       | 47 Shitje                             |
| 24 Të shkruash raporte               | 48 Të arkivosh letra dhe raporte      |

**Hapi Dy:** Në tabelën më poshtë rretho sërish numrat e titujve që të kanë pëlqyer. Pastaj numëro sa është numri për secilin rresh dhe shkruaje atë numër në katrorin në të majtë. Dy kategoritë me numrat më të lartë janë grupet e profesioneve ku ke më shumë interesim dhe etiketat korresponduese janë Kodi Holland i yti. (Për shembull, nëse keni pikët më të larta në kategorinë Sociale dhe e dyta pas saj vjen Artistike, Kodi Holland i yti është "SA". Atëherë këtu duhet t'i përqëndrosh përpjekjet për të eksploruar drejtimin e karrierës.)

R	1	7	13	19	25	31	37	43
H	2	8	14	20	26	32	38	44
A	3	9	15	21	27	33	39	45
S	4	10	16	22	28	34	40	46
N	5	11	17	23	29	35	41	47
T	6	12	18	24	30	36	42	48

Rezultati më i lartë: \_\_\_\_\_ Rezultati i dytë më i lartë: \_\_\_\_\_

Rezultati i tretë më i lartë: \_\_\_\_\_ Kodi Holland i imi: \_\_\_\_\_

(3 shkronja p.sh. AHR, SNH, TRN etj.)

R = REALIST
H = HULUMTUES
A = ARTISTIK
S = SOCIAL
N = NDËRMARRËS
T = TRADICIONAL

### Përshkrime të llojeve të personalitetit

#### REALIST

“Veprues” realist. Këta individë preferojnë të punojnë me objekte, gjëra, makineri, bimë ose kafshë. Ata kanë aftësi mekanike, iu pëlqen të rrinë jashtë dhe të përdorin duart për të punuar.

- Trup të fortë, të fuqishëm, praktikë, fizikisht të fortë
- Nuk ndjehen rehat në mjedise kur ka shumë njerëz
- Kanë koordinim motorik të mirë
- Shkathësi të dobëta verbale dhe ndërpersonale
- E shohin veten me prirje mekanike dhe atletike
- Të qëndrueshëm, natyralë, këmbëngulës
- Preferojnë probleme konkrete kundrejt atyre abstrakte
- Kanë synime politike dhe ekonomike tradicionale
- Rrallëherë performojnë në mënyrë kreative në arte apo shkencë
- U pëlqen të ndërtojnë gjëra me mjete
- U pëlqen të punojnë në natyrë
- Nuk janë shumë të hapur ndaj ideve të reja radikale



- U pëlqen të punojnë me makineri të mëdha, të fuqishme
- Blejnë varka, shkojnë në kamping, skijim, përdorin motoçikleta

### HULUMTUES

“Mendimtarë” hulumtues. Këta individë janë të interesuar për shkencat dhe logjikën. Atyre u pëlqen të analizojnë, vlerësojnë dhe zgjidhin problem, si dhe u pëlqen të mësojnë dhe të kuptojnë shkaqet e ngjarjeve.

- Orientim shkencor
- Të orientuar nga detyrat, të fokusuar tek puna e tyre
- Meditues dhe asocialë
- Mendojnë mirë para se të veprojnë
- Kanë nevojë të fuqishme të kuptojnë botën
- U pëlqejnë detyrat dy kuptimëshe
- Preferojnë të punojnë në mënyrë të pavarur
- Kanë qëndrime jo tradicionale
- E shohin veten sikur u mungojnë aftësitë udhëheqëse
- Kanë besim tek aftësitë e tyre intelektuale
- Analitikë, kureshtarë, të rezervuar, të pavarur
- Nuk u pëlqejnë fare aktivitetet që përsëriten
- Blejnë teleskopë, makina llogaritëse, pajisje elektronike

### SOCIALË

“Ndhimdhënësit” Socialë. Këtyre individëve u pëlqen të punojnë me të tjerë. Atyre u pëlqen të japin mësim, të ndihmojnë dhe mjekojnë të tjerët. Ata janë të zotë me fjalët.

- Të shoqërueshëm, të përgjegjshëm, humanë, fetarë
- U pëlqen të punojnë në grupe
- Kanë shkathhtësi verbale dhe ndër-personalë
- Shmangin edhe zgjidhjet intelektuale të problemeve, edhe ushtrimet fizike
- U pëlqen të shërojnë, zhvillojnë, trajnojnë ose edukojnë/shkollojnë të tjerët
- Janë të mirë kuptueshëm, ndihmues, idealistë
- Nuk u pëlqen të punojnë me makineri apo

në situata shumë të strukturuar

- U pëlqen të diskutojnë çështje filozofike
- Shqetësohen për mirëqenien e të tjerëve
- Janë bashkëpunues, miqësorë, bujarë
- Ndjekin punëtori/workshope apo përvoja të tjera grupore

### NDËRMARRËS

“Bindës” Ndërmarrës. Këtyre individëve u pëlqen të ndikojnë, bindin apo udhëheqin të tjerët dhe të menaxhojnë të tjerët. Atyre u pëlqen të punojnë me ekipe drejt synimeve, të merren me aktivitete konkurruese dhe biznesore.

- Shkathhtësi të mira verbale, bindës
- Udhëheqës të fortë
- Shmangin punën që kërkon periudha të gjata, mundim apo angazhim intelektual
- Shtytje e fuqishme për të arritur qëllimet e organizatës
- Vrasin mendjen për pushtet, status dhe lidhshëm
- Janë agresivë, të pëlqyer nga të tjerët të shoqërueshëm, me vetëbesim
- Kanë nivele të larta të energjisë, janë aventurierë dhe ambiciozë - U pëlqen të realizojnë gjërat
- Vlerësojnë paranë dhe të mirat materiale
- Nuk u pëlqen shkenca apo të menduarit sistematik
- Blejnë makina të mëdha, rroba të bukura dhe anëtarësohen nëpër klube

### TRADICIONALË

“Organizatorë” Tradicionalë. Këta individë janë të orientuar nga detajet dhe janë të organizuar mirë. Atyre u pëlqen të analizojnë të dhëna, të mbajë dokumente financiarë dhe të bëjnë hulumtime. Atyre mund t’u besohet se janë të saktë dhe u pëlqen struktura dhe përmbyllja e veprimeve.

- Preferojnë mjedise të organizuara mirë
- U pëlqejnë aktivitete sistematike, verbale dhe numerike

- Shmangin situatat dhe problemet me dy kuptime
- Të ndërgjegjshëm, efikasë, praktikë
- Identifikohen me pushtetin
- Vlerësojnë të mirat materiale dhe statusin
- Të rregullt, këmbëngulës, të qetë
- Nuk u pëlqejnë sjelljet e lira, jo sistematike, eksploruese në fusha të reja
- Nuk kërkojnë lidhë nga jashtë
- Të qëndrueshëm, të kontrolluar, të besueshëm
- Janë më efektivë me detyra të përcaktuara qartë
- Kursejnë para, por jo në mënyrë konservatore

### ARTISTIKË

“Krijuesit” Artistikë. Këta individë janë artistikë dhe u pëlqejnë ndryshimet. Ata e shijojnë kur përdorin imagjinatën, kreativitetin, ndjenjat dhe intuitën. Atyre u pëlqen të punojnë në vende ku janë të lirë të caktojnë orarin e tyre.

- U pëlqen arti, muzika, drama, interesa të tjera kreative
- Preferojnë situata të lira, të pa strukturuara
- Impulsivë, jo konformistë, të pavarur
- Nuk i duan rregullat
- Merren me probleme përmes shprehjes me art
- Vlerësojnë bukurinë dhe cilësitë estetike
- Janë ekspresivë, origjinalë, intuitivë
- U pëlqen të punojnë në mjedise të lira
- U pëlqejnë grupet e vogla, intime
- Të gatshëm të marrin parasysh rreziqe për të provuar diçka të re
- Vishen me stile më të shkira se të tjerët
- Kanë nevojë për shprehje të individualitetit
- Nuk janë këmbëngulës për aftësitë e tyre
- Sensitivë dhe emocionalë
- Shpenzojnë para për objekte arti—libra, piktura, DVD, CD



Një nga mënyrat që do të zgjedhësh për të eksploruar karrierën është të vëzhgosh profesionet sipas interesimit që keni për profesionin tuaj. Holland ka bërë një hulumtim që i ndan nxënësit/punëkërkuarit në gjashtë kategori të përgjithshme të personalitetit: • Realistë • Artistikë • Ndërmarrës • Hulamtues • Socialë • Tradicionalë.”

## 1.10. Vendosja e objektivave (Sesioni 1)

Nxënësit do të kuptojnë dhe fitojnë shprehuri të qarta, se si ata kanë të drejtë të kujdesen për veten tyre dhe përgjegjësinë të bëjnë zgjedhje të zgjuara në karrierë dhe kujdesen për vetën tyre.

**Objektivi mësimor:** Nxënësit do të jenë në gjendje të:

- njihen me rëndësinë e përcaktimit të qëllimeve afatshkurtra, afatgjata dhe të përjetshme.

Materialet

Revista, imazhe në internet, vepra arti personale, foto, etj.

### Udhëzime për mësimdhënësit

Diskutime (përcaktimi i objektivave)

- Çfarë është një qëllim?  
Diçka e dëshiruar dhe e punuar drejt
- Cilët janë disa shembuj të qëllimeve?  
Marrja e një "5" në një test, kursimi për një trotinet, praktikimi i pianos, krijimi i një ekipi atletik, të jesh një shok i mirë, mbarimi i klasës së tetë.
- Çfarë qëllimesh keni arritur?  
Të mësoni të ngisni një biçikletë, të mos humbisni kurrë një ditë në shkollë ose të kurseni paratë tuaja për një lodër e veçantë.
- Si u ndjetë pasi arritët qëllimin tuaj?
- Pse qëllimet janë të rëndësishme dhe çfarë mund të bëjnë ato për ju?  
Jep një qëllim për punë, rrit efektivitetin, vendimmarrje më të mirë, ka më shumë besim.

### Qëllimet afatshkurtra, afatgjata dhe të përjetshme

(Diskutime)

- Cili është një shembull i një qëllimi afatshkurtër?
- Cili është një shembull i një qëllimi afatgjatë?
- Cili është një shembull i një qëllimi që përmbushet gjatë gjithë jetës?
- Sa janë të njëjta qëllimet afatshkurtra, afatgjata dhe të përjetshme? Si dallojnë?
- Si mund të ndihmojnë qëllimet afatshkurtra në arritjen e qëllimeve afatgjata/gjatë jetës?
- Çfarë qëllimi mund të arrini në 24 orët e ardhshme?
- Çfarë qëllimi mund të arrini brenda një viti?
- Çfarë karriere do të dëshironit të ndiqnit në të ardhmen?
- Çfarë qëllimesh keni që përmbushen gjatë gjithë jetës? (a keni ndonjë qëllim të përjetshëm?)
- Si mund ti arrini qëllimet tuaja?

### Aktiviteti-Pantomimë për vendosjen e qëllimeve

(Loja)

- Ndani klasën në grupe të vogla prej tre deri në pesë nxënës.
- Çdo nxënës vendos për një qëllim të afatshkurtër, afatgjatë ose të përhjetshëm.
- Nxënësi bën si pantomimë qëllimin e tij/saj para grupit të vogël.
- Grupi përpiket të qëlluj/ zbuloj qëllimin që po pantomimohet

### Plani për Sukses

(Diskutime)

Shpërndani fletën e punës për nxënësit, “Plani për Sukses: Një qëllim afatshkurtër”.

- Do të praktikojmë të shkruajmë një qëllim dhe të krijojmë një plan veprimi për të arritur atë qëllim.
- Mendoni për qëllimin tuaj dhe pyesni veten:
- Cilët janë disa njerëz që mund të më ndihmojnë të arrijë qëllimin tim?
- Nëse qëllimi im përfshin të tjerët, si mund të marr një fitore të favorshme?
- Çfarë opsionesh kam?
- Çfarë do të bëj çdo ditë për të arritur qëllimin tim?

### Konkluzione

Përgatitja e kolazheve

- Mblidhni fotografi ose imazhe që shprehin vizualisht ëndrrat, qëllimet e karrierës, aspiratat dhe vizionet tuaja.
- Vendosni ose ngjitni fotografitë në një poster për të krijuar një kolazh të ëndrrave dhe qëllimeve tuaja.

### Shfaq kolazhet e nxënësve.

#### Vizualizimi i së ardhmes:

Nxënësit duhet të kenë para vetes diçka për të shkruar.

Aktiviteti është menduar të jetë i qetë dhe reflektues.

Kërkojuni nxënësve të mendojnë për pyetjen e mëposhtme, por mos të shkruajnë ose vizatojnë asgjë derisa t’u jepni shenjën përkatëse:

- Çfarë do të ndodhte nëse do të arrinit qëllimet që i keni vënë vetes sot? Si do të ndiheshit? Çfarë mund të ndryshojë?

Jepni një pauzë prej 20-30 sekondash. Më pas bëjini të ditur nxënësve se do të kenë dy minuta për të shkruar ose vizatuar, por se duhet të bëjnë çmos që të mbajnë lapsin ose stilolapsin në lëvizje.

Filloni matjen e kohës për dy minuta. Nxitini nxënësit të vazhdojnë të shkruajnë ose të vizatojnë, edhe nëse nuk janë të sigurtë se çfarë të shkruajnë.

Kur koha kalon, pra, pas dy minutash, kërkonin nga nxënësit të ndalojnë kudo që të jenë. Kërkojuni atyre të përfytyrojnë veten duke jetuar çfarëdo që ata kanë imagjinuar. Ata mund të mbyllin sytë. Pas një minute, njoftojini se aktiviteti ka përfunduar.

Nxënësit mbajnë shënime për mësimin dhe ndajnë komentet e tyre me mësimdhënësin.

#### Detyrë shtëpie:

Nxënësit pyesin një anëtar të familjes për vizionin e tyre për jetën e tyre kur ishin në moshën e tyre.

## 1.11 Vendosja e qëllimeve (Sesioni 2)

### Optimizimi/efektiviteti i të mësuarit tuaj – Qëllimi SMART

#### Përshkrim

Aktiviteti “Optimizimi i të mësuarit tuaj” do t’i lejojë nxënësit të zbulojnë se kanë aftësinë për të menaxhuar një sërë sfidash duke përdorur një sërë burimesh dhe mbështetjesh që janë në dispozicion të tyre. Ky mësim prezanton vendosjen e qëllimeve S.M.A.R.T., ndërsa nxënësit hartojnë dhe më pas zbatojnë një plan vetë-menaxhimi. Nxënësve do t’u kërkohet të identifikojnë sfidat që pengojnë të mësuarit e tyre dhe të mendojnë për strategjitë që do t’i ndihmojnë ata të përfitojnë sa më shumë nga mundësitë e të mësuarit. Nxënësit do ta mbyllin mësimin me krijimin e një qëllimi akademik S.M.A.R.T.

#### Rezultatet e të nxënit që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- përshkrimin dhe krijimin e qëllimit të tyre S.M.A.R.T;
- identifikimin e sfidave me të cilat përballen si nxënës;
- artikullimin e strategjive mbështetëse për t’i ndihmuar ata në adresimin e këtyre sfidave dhe arrijtjen e qëllimeve të tyre.

#### Aktivitet

(Gjithë grupi)

Çfarë është diçka që shpresoni të arrini këtë vit?  
Çfarë është diçka që shpresoni të arrini përtej këtij viti?

Nxënësit do t’i përgjigjen kërkesës në një fletë që ngjitet (post-it?), e cila mund të postohet

ngjitet/vendoset diku që nxënësi të mund ta shohë gjatë gjithë mësimit.

#### Aktiviteti:

Qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata

Prezantoni një përmbledhje të qëllimit SMART, duke shpjeguar se çfarë përfaqëson çdo shkronjë.

Zbërthimi i qëllimit SMART: Nxënësit duhet të punojnë në çifte për të zbërthyer qëllimin SMART dhe të shkruajnë provat e tyre në mbështetje të përmbushjes së qëllimit për secilën shkronjë në SMART.

- **Specifike:** A është qëllimi i saktë dhe i detajuar?
- **E matshme:** A janë në gjendje të tregojnë se kur keni bërë përparim?
- **E arritshme:** A jeni a në gjendje ta përmbushni qëllimin tuaj relativisht lehtë?
- **Relevante/përshtatshme:** A është qëllimi i lidhur me atë që ata duan të bëjnë vërtet?
- **Në kohë:** Në çfarë kohe do ta arrijnë këtë qëllim?

#### (Grupe te vogla)

Qëllimet SMART:

Duke përdorur përgjigjet e tyre, nxënësit, në grupe të vogla me 3-4 nxënës, do të kenë mundësi për të krijuar qëllimet e tyre të ardhshme SMART. Nxënësit që mund të jenë të pasigurt ose kanë vështirësi në përcaktimin e një qëllimi SMART mund të marrin mbështetje nga anëtarët e grupit. Pas disa minutash shkrimi, ata do të inkurajohen të ndajnë qëllimet e tyre me grupin, nëse ndjehen të kënaqur/ komfort ta bëjnë këtë.

**(Gjithë grupi)****Sfidat e të mësuarit dhe kërkimi i resurseve/ burimeve:**

Nxënësit bëjnë aktivitetet për të eksploruar disa nga strategjitë e diskutuara.

Reflektimi i nxënësve mund të bëhet me shkrim.

Reflektim me shkrim:

Nxënësit do të plotësojnë në mënyrë të pavarur një reflektim me shkrim rreth strategjive të të mësuarit që ata mund t'i zgjedhin vetë.

“3 strategjitë e mia më të mira të të mësuarit janë...”

“Zgjedha këtë strategji sepse...”

“Kjo strategji do të më ndihmojë...”

**(Diskutim në grup të vogël ose në çift)****Diskutim:**

Nxënësit do të votojnë dhe do të zgjedhin 3 strategjitë e të mësuarit që kanë zgjedhur, pastaj t'i ndajnë rezultatet me klasën për të parë se cilat ishin strategjitë kryesore të përzgjedhura.

Më pas nxënësit do të kenë mundësinë të diskutojnë për këto rezultate.

- Si mund ta mbështesim njëri-tjetrin përderisa përdorim këto strategji?
- Kujt mund t'i drejtohem për mbështetje duke përdorur këto strategji?
- Cili është një qëllim SMART që mund të bazohet në strategjitë që më duhet të përdor këtë vit?

Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur për të shkruar një qëllim akademik SMART. Kujtojeni nxënësve pyetjet udhëzuese të përdorura më parë në mësim, ndërsa ata kontrollojnë për t'u siguruar që qëllimi i tyre ka secilin komponent.

- Specifike: a është qëllimi juaj i saktë dhe i detajuar?
- E matshme: A jeni në gjendje të tregoni kur keni bërë përparim/ kur e keni arritur?
- E arritshme/E arritshme: A jeni në gjendje ta përfundoni qëllimin tuaj relativisht lehtë?
- Relevante/përshtatshme: A është qëllimi juaj i lidhur me atë që vërtetë dëshironi të bëni
- Në kohë: Në çfarë kohe do ta arrini këtë qëllim?

**Detyre shtëpie:**

Nxënësit pyesin një anëtar të familjes se çfarë strategjish përdorin ata kur përjetojnë sfida dhe nëse ata mund ti ndajnë strategjitë që kanë zgjedhur për tejkalimin e sfidave. Nxënësit gjithashtu inkurajohen që ti ndajnë qëllimin e tyre SMART me anëtarin e familjes.

**Objektivi origjinal: Çfarë dua të arrij?**

## OBJEKTIVAT S.M.A.R.T

**E MATSHME**

Si do ta dini kur e keni arritur qëllimin tuaj? Si do ta matni suksesin tuaj?

**E ARRITSHME**

Çfarë ndryshimi mendoni që do të ndodhë në momentin që do të arrini qëllimin tuaj? A do të jetë ky ndryshim i realizueshëm?

**REALE/  
RELEVANTE**

Çfarë ndryshimi shpresoni se do të ndodhë kur të arrini objektivin tuaj? A është ky ndryshim real?

**NË KOHË**

Kur do të realizohet qëllimi juaj?

**Objektivat  
S.M.A.R.T**



### Udhëzime për mësime të mësimdhënësve

- Ky është menduar të jetë një aktivitet i shkurtër për të inkurajuar të menduarit e orientuar drejt së ardhmes.
- Ky shpjegim mund të shkurtrohet ose zgjatet në varësi të njohurive të nxënësve për qëllimet SMART.
- Ndërsa nxënësit reflektojnë, mësime të mësimdhënësve angazhohet me secilin grup dhe do të ofrojë rekomandime për resurset nëse ata nuk janë të sigurt.

## 2. Informacione në lidhje me profesionet

### 2.1 Eksplorimi i grupeve të profesioneve-karrierës (Sesioni 1)

Nxënësit do të njihen me 16 grupe të profesioneve. 16 grupet e profesioneve organizohen në profesione të ndryshme në tema të përbashkëta. Në këtë mësim përdoret një strategji narrative për të hulumtuar perceptimet e tyre për 16 grupet e profesioneve që u duken interesante, të eksplorojnë tema të përbashkëta midis profesioneve në tre grupe e para përpara si dhe të hulumtojnë në mësimin vijues profesionet në internet (psh. Platforma Busulla.com).

#### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- analizimin, vlerësimin dhe reflektimin mbi interesat dhe motivimin personal të lidhur me një gamë ose grupe të mundshme të profesioneve;
- vlerësimin e niveleve aktuale të vetë-efikasitetit dhe vetëbesimit të dikujt që lidhen me marrjen në konsideratë të një sërë mundësish të grupeve të profesioneve.

#### Aktivitetet

Kërkesa: Cilat aktivitete ose orë mësimore ju pëlqejnë më shumë? Pse ju pëlqejnë ato?

*(Gjithë grupi)*

Nxënësit do të hulumtojnë në mënyrë të pavarur në platformat online ( Busullë)

përshkrimet e profesioneve të ndryshme dhe do të zgjedhin tre fushat e tyre kryesore të interesit.

*(Grupe të vogla)*

Ndani nxënësit në grupe të vogla për të diskutuar rezultatet e anketës së tyre të interesit.

Kërkesat e diskutimit:

- Cilat grupe kryesore të profesioneve zgjodhëm?
- Zgjidhni tri grupe të profesioneve që ishin të zakonshme në grupin tuaj. Në çfarë mënyrash janë të ngjashme këto grupime? Në çfarë mënyrash janë të ndryshme?

Lejoni grupet e vogla të ndajnë diskutimin e tyre.

#### Reflektim/Përmbledhje

Pyetje për diskutim: Të gjithë kishin 3 grupe kryesore, por pas përfundimit të anketës zgjodhën një grup për të eksploruar më tej. Pse zgjodhët grupin e caktuar?

**Detyrë shtëpie:** Nxënësit do të hyjnë në Busullë me një anëtar të familjes për të hulumtuar. Ata mund të zgjedhin dhe eksplorojnë së bashku një grup tjetër të profesioneve.

#### Udhëzime për mësimdhënësit

- Jepuni nxënësve një mundësi të mendojnë për përgjigjet e tyre, të diskutojnë në çift me një bashkëmohatar (nxënës të klasës) dhe të ndajnë mendimet e tyre.
- Ka shumë mënyra për të angazhuar nxënësit me këtë aktivitet. Zgjidhni opsionin që funksionon më se mirë për nxënësit tuaj.
- Ky hulumtim është menduar të jetë i pavarur dhe i hapur si dhe tu jepet kohë e mjaftueshme nxënësve për ta bërë atë.



## 2.2 Eksplorimi i grupeve të profesioneve-karrierës (Sesioni 2)

16 Grupet e Profesioneve organizohen në profesione të ndryshme më tema të përbashkëta. Pas përfundimit të një strategjie narrative për të hulumtuar perceptimet e tyre për 16 grupet e profesioneve që atyre ju duken interesante dhe duke eksploruar tema të përbashkëta nëpër profesione në tre grupe, ata do të hulumtojnë ato në platformat online - Busullë. Nxënësit do të kenë kohë të eksplorojnë rezultatet e hulumtimit nga Busulla dhe të marrin në konsideratë zgjedhjet e tyre të grupeve.

### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- analizimin, vlerësimin dhe reflektimin mbi mbi interesat dhe motivimin personal të lidhur me një gamë ose grupe mundësish të profesioneve;
- angazhim në eksplorimin dhe ekzaminimin e grupeve të ndryshme të profesioneve;
- reflektim mbi besimet, mendësitë dhe paragjykimet që mund të përshtatet me interesin e tyre në grupet e karrierës që ata dëshirojnë të marrin në konsideratë.

### Aktivitetet

#### *(Gjithë grupi)*

Zgjidhni një grup të profesioneve që nuk hyri në treshen tuaj më të mirë. Çfarë lloje profesionesh ekzistojnë në këtë grup? Kur merrni parasysh profesionet në këtë grup, a ju intereson ndonjë prej tyre? Pse mund të keni zgjedhur grupet e profesioneve që keni zgjedhur dhe të mos keni zgjedhur të tjera? Nëse është e

mundur, nxënësit do të hulumtojnë në mënyrë të pavarur profesione në Busullë dhe plotësojnë pyetjet e mëposhtme të reflektimit.

#### Reflektimi:

- A përputheshin rezultatet e këtij vlerësimi me rezultatet e anketës/hulumtimit tuaj? Pse mendoni se përputhen apo nuk përputhen?
- A ka grupime shtesë që mund t'i eksploroni pas përfundimit të këtij vlerësimi? Cilat janë ato?
- Identifikoni një grup për të eksploruar. Cilat janë 2-3 profesione në këtë grup? Çfarë kanë të përbashkët?

#### *(Grupe të vogla)*

Nxënësit do të ndahen në grupe të vogla për të diskutuar rezultatet e hulumtimit të tyre

#### Pyetje për nxënësit:

- A patët të njëjtat rezultate? Apo kenë ndryshe?
- A ka grupime që asnjëri nga ju nuk i kishte në rezultatet tuaja? Pse nuk na kanë tërhequr apo nuk i kemi marrë në konsideratë ato grupime?

### Reflektim/Përmbledhje

Ndani atë që është diskutuar në grupe të vogla me të gjithë klasën.

**Detyrë shtëpie:** Nxënësit ndajnë rezultatet e hulumtimit të tyre me një anëtar të familjes. Ata diskutojnë rreth grupimeve të profesioneve që i kanë marrë në konsideratë dhe cilat grupime nuk i kanë konsideruar kurrë më parë, por mund të duan tani ti eksplorojnë.

#### Udhëzime për mësimdhënësit

- Diskutoni në dyshe ose në klasë. Ideja është që t'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë se mund të ketë opsione edhe jashtë grupeve që u përzgjedhën fillimisht dhe të konsiderojnë se disa nga identitetet e tyre personale ose besimet për veten e tyre mund t'i kenë dekurajuar ata të marrin në konsideratë grupime të tjera që mund t'iu pëlqejnë.
- Sigurohuni që nxënësit të ruajnë hulumtimin e tyre në portofolin me shkrim.

## 2.3 Planifikimi i karrierës

**Pjesa hyrëse:** Shpjegoni se është e rëndësishme për nxënësit që t'i marrin parasysh rolet në vendet e punës për t'i dhënë një pasqyrë më të mirë të botës së punës. Ky është një aktivitet argëtues që ka një komponent serioze të të nxënit. Shpesh të rinjtë kanë ide joreale për punë të ndryshme, ku ky aktivitet është i dizajnuar për t'u ndihmuar atyre që t'i marrin parasysh idetë e vendeve të punës në më shumë hollësi.

### Rezultatet mësimore:

Të rritet vetëdijesimi dhe njohuritë e nxënësve rreth roleve në vendet e punës dhe të aktiviteteve të punës nëpërmjet komunikimit gojor në një mjedis grupor, që është një aktivitet argëtues për të angazhuar nxënësit dhe për të shfrytëzuar kreativitetin.

Nxënësit punojnë në: grup, çifte

Aktiviteti kryesor Nxënësit punojnë si 2 ekipe ose mund të punojnë në çifte. Pasi ekipet të jenë përzgjedhur, emërohet një zëdhënës për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të bërë pyetje në emër të ekipit. Megjithatë ata janë të inkurajuar që ta diskutojnë çështjen si ekip para se ta parashtrojnë për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Një ekip zgjedh një letër të vendit të punës (sipas listës së më poshtme të profesioneve) në mënyrë të rastësishme dhe pastaj ndan kohë për të diskutuar se çfarë përfshin ajo punë dhe cilat aktivitete do të ishin pjesë e atij roli.

Ekipi tjetër ka 20 pyetje për të provuar ta qëllojë rolin në vendin e punës, duke parashtruar pyetjet me po/jo. Përgjigjet mund të jenë vetëm PO apo JO.

Shembujt e pyetjeve

- A duhet të keni diplomë fakulteti për ta kryer këtë punë?
- A jeni mashkull apo femër?
- A mbani uniformë?
- A përdorni vegla pune?

Ekipi mund të qëllojë përgjigje se për çfarë pune bëhet fjalë në çfarëdo kohë të lojës. Në qoftë se e qëllon si të saktë, ekipet ndërrohen, në qoftë se nuk arrijnë të qëllon si të saktë deri në fund të 20 pyetjeve, atëherë përzgjidhet një letër e re e vendit të punës. Në fund, ekipi me më së shumti përgjigje të sakta është fitues.

Diskutimi i mëtejme

Nxënësit inkurajohen të hyjnë në diskutime në kuadër të ekipeve të tyre gjatë lojës dhe kjo pjesë mund të udhëhiqet nga mësimitdhënësi. Ky aktivitet mund të mbështesë diskutime të mëtejme në klasë, ku hulumtimi, nëse kërkohet, mund të inkurajohet nga mësimitdhënësi.

Lista e propozuar profesioneve (kjo listë mund të plotësohet edhe me profesione të tjera)

Infermier
Punëtor në dyqan, shitës??
Përkthyes
Zyrtar policor
Mësimdhënës
Pjesëtar i forcave të armatosura
Bibliotekist
Ndërtues
Inxhinier
Bujk
Artist
Punëtor zyre
Kamerier
Menaxher hoteli

## 2.4 Çfarë pune do të bëni?

Hyrje fillestare në detyrat e shtëpisë - 10 minuta  
Prezantimet -

Nxënësit punojnë:

- në çifte,
- në grupe të vogla prej 4 – 6 vetë.

Rezultatet mësimore: Një projekt kërkimor për nxënësit që të zbulojnë se çfarë pune bënë familja e tyre, cilat janë detyrat e tyre të përditshme dhe mënyrat se si kanë hyrë në punë. Kjo do t'i prezantohet përsëri klasës.

Kriteret e suksesit:

- Hulumtimi – ndërmarrja e hulumtimit, shqyrtimi i vendeve të punës së familjarëve;
- Shkathësitë prezantuese – Prezantimi i konstatimeve të tyre në klasë;
- Inkurajim diskutimesh dhe shkathësisht hulumtuese; diskutimin mbi rolet në vendet e punës, mënyrat e gjetjes së punës, cilësitë, shkathësitë dhe vetitë personale.

Pjesa hyrëse: Projekt hulumtimi për detyrën e shtëpisë

Caktoni një projekt / detyrë shtëpie duke i ndarë nxënësit në grupe prej 3 nxënësve. Secili nxënës duhet të bisedojë me familjarë të vet lidhur me atë se çfarë pune bëjnë. Nxënësit duhet të kuptojnë sa më shumë lidhur me punën. Duke punuar në grupe prej 3 nxënësve, ata duhet të vendosin se cilën punë do t'ia paraqesin klasës, kush do ta prezantojë atë (një, dy apo të tretë prej tyre) dhe do të punojnë së bashku si ekip. Në orën tjetër mësimore do të bëjnë një prezantim prej 5 minutash për pjesën tjetër të klasës.

### Aktiviteti kryesor Projekt hulumtimi - detyrë shtëpie për nxënësit

Caktoni një projekt detyrë shtëpie, ndani nxënësit në grupe prej 3 personave. Secili nxënës duhet të bisedojë me familjarë të vet lidhur me atë se çfarë pune bëjnë. Nxënësit duhet të kuptojnë sa më shumë lidhur me

punën. Duke punuar në grupe prej 3 vetëve, ata duhet të vendosin se cilën punë do t'ia paraqesin klasës, kush do ta prezantojë atë (një, dy vetë apo të tretë prej tyre) dhe do të punojnë së bashku si ekip. Në orën tjetër mësimore do të bëjnë një prezantim prej 5 minutash për pjesën tjetër të klasës. Pasi t'i kenë siguruar të gjitha informatat e nevojshme, duhet ta prezantojnë këtë në orën tjetër mësimore para pjesës tjetër të klasës. Ata mund të përdorin materiale ndihmëse, mjete të paraqitjes vizuale apo materiale të shtypura. Nxitni nxënësit që të jenë krijues dhe ta bëjnë prezantimin në një mënyrë kreative për të angazhuar shokët e tyre.

Ky aktivitet nxit diskutimin me familjen në lidhje me idetë e tyre të karrierës dhe rrit njohuritë e tyre për opsionet e mundshme të vendeve të punës në dispozicion të tyre. Ky aktivitet po ashtu rrit vetëdijësimin e mënyrave të gjetjes së punës, kualifikimeve të mundshme, nevojës për trajnim të vazhdueshëm dhe zhvillim në vendin e punës. Aktiviteti gjithashtu i vetëdijëson nxënësit lidhur me realitetin e punës, cilat janë detyrat e përditshme, përparimin brenda kompanisë dhe çka duhet të bëjnë për të punuar drejt synimit të tyre në karrierë, për shembull, ndoshta duhet të fillojnë në fund e të punojnë drejt rrugës së tyre për në majë.

Aktiviteti gjithashtu zhvillon shkathësitë e tyre prezantuese, të cilat ata do t'i përdorin kur të kërkojnë punë dhe të marrin pjesë në intervista, duke ndërtuar vetëbesimin e tyre dhe duke nxjerrë në pah fushat për zhvillim.

### Diskutimi i mëtejshëm

Pasi të kenë bërë prezantim grupet në klasë, mund të zhvillohen pyetjet dhe diskutime të tjera. Kjo mund të çojë në kërkime të mëtejshme për vendin e punës që mund t'u interesojë nxënësve të caktuar. Duke shikuar se cilat kualifikime u duhen, në çfarë kolegje duhet të shkojnë dhe nëse ato vende të punës janë në dispozicion në zonat e tyre lokale.

Moduli

2

## 3. Opsionet e shkollimit dhe karrierës:

### 3.1 Rrugët e shkollimit dhe profesionit

Marrja e informacioneve për arsimin e mesëm të lartë në regjionin e tyre të cilat janë të rëndësishme për nxënësit gjatë përzgjedhjes së shkollimit dhe profesionit. Këto informacione mund të merren gjatë vizitave të shkollave profesionale në ditët e dyerve të hapura, informacione për shkollat në Busulla.com ose në facebookun e shkollave, dhe informacione të tjera të printuara.

#### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- njohuri për sistemin e shkollimit në Kosovë;
- krijimin e ideve në lidhje me mundësitë rajonale të shkollimit dhe/ ose punësimit;
- njohjen e burimeve informuese mbi shkollat dhe/ose tregun e punës (Busulla, televizioni, interneti, ditët e hapura, etj).

#### Aktivitet

#### Ushtrim individual

Kërkoni nga pjesëmarrësit që të hulumtojnë në

Busullë shkollat që do ti përgatisin më mirë, krahasojnë llojet e shkollave, dhe analizojnë gjendjen në treg të profesioneve të dëshiruara, si dhe të profesioneve të mundshme alternative.

Nxënësit u përgjigjen pyetjet:

- Cila shkollë i përmbushë kërkesat e mia?
- Në cilat lëndë në veçanti do duhet të jem i mirë?
- Profesioni im i dëshiruar a ka më shumë të bëj me punë dore, punë me makina, punë mendore apo ka më shumë kontakt me njerëzit?
- A përshtaten kërkesat shkollore me profilin tim personal?
- Cila rrugë e karrierës më ndihmon të realizoj profesionin tim të dëshiruar?

**Detyrë shtëpie:** Nxënësit ndajnë dhe diskutojnë me prindërit të priturat e tyre shkollore dhe profesionale duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit të tyre rreth shkollave që atyre ju interesojnë në regjionin e tyre e që i kanë marrë në konsideratë.

#### Udhëzime për mësimdhënësit

- Shpjegoni dhe ndihmohuni nxënësit të kuptojnë pse kanë zgjedhur fillimisht ato dhe të konsiderojnë se si interesat e tyre me pikat e tyre të forta dhe talentet e tyre kundrejt kërkesave të shkollave dhe profesioneve të preferuara mund t'i kenë inkurajuar ata të marrin në konsideratë ato shkolla.
- Sigurohuni që nxënësit të ruajnë hulumtimin e tyre në portofolin me shkrim.

**PYETËSORË për njohjen e „Shkollave për arsim të mëtutjeshëm“**

Shkolla: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Personi kontaktues: \_\_\_\_\_

Numri i nxënësve në shkollë: \_\_\_\_\_

Tipi/lloji i shkollës: \_\_\_\_\_

**1 Profesione pas shkollimit**

Për cilat profile ofrohet shkollim në këtë shkollë?

**2 Lëndë të rëndësishme mësimore**

Cilat janë lëndët më të rëndësishme mësimore?

Si është ndarja në mes të lëndëve të përgjithshme dhe lëndëve profesionale?

Në cilat lëndë është mësimi praktik (p.sh. në punëtori në formë projektesh), dhe në cilat lëndë është mësimi teorik, pra në klasë?

Sa kohë zgjatë ky shkollim?

**3 Kërkesat**

Cilat janë kërkesat që parashtrihen karshi personalitetit, p.sh. dëshira për të mësuar, kënaqësia për të mësuar? Cilat janë interesimet që duhet pas?

Çfarë është e nevojshme për tu pranuar në këtë shkollë? A ka provim pranues? Çka testohet në këtë provim? Sa pikë nevojiten për pranim?

A është kërkesa e madhe për tu regjistruar në këtë shkollë apo jo?

**4 Perspektiva**

Cilat mundësi shkollimi ofrohen pas përfundimit të kësaj shkolle? A inkuadrohen lehtë apo vështirë të diplomuarit e kësaj shkolle në treg të punës?

Për çfarë arsye?

**5 Përparësitë dhe mangësitë**

Çka vlerësojnë nxënësit apo të diplomuarit e kësaj shkolle si përparësi të kësaj shkolle?

Çka vlerësojnë nxënësit apo të diplomuarit e kësaj shkolle si mangësi të kësaj shkolle?

## 3.2 Kriteret për zgjedhjen e shkollës


Nxënësit bëjnë vetëvlerësimin dhe vlerësimin e kriterëve për zgjedhjen e mëtutjeshme të shkollës në pajtueshmëri me potencialin e vet dhe në pajtueshmëri me kërkesat e profesionit.

### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- të kuptojnë rëndësinë që ka zgjedhja e shkollës për karrierën profesionale;
- të kërkojnë mendimet e të tjerëve në lidhje me këtë;
- të kuptojnë, që në zgjedhjen e shkollës ndikojnë si personaliteti vetjak ashtu edhe kushtet e jashtme;
- të kuptojnë faktorët, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e shkollës.

### Aktivitet

- 1 Mësimdhënësi ka përgatitur kartela me profesione/sectorë profesionalë të ndryshëm nga Busulla në varësi të mundësive të shkollimit në shkollat e mesme të larta. Prej këtyre kartelave nxënësit tërheqin vetëm një.



Secili prej nxënësve mendohet nëse ai do të ishte i kënaqur me këtë zgjedhje apo jo. Në varësi të këtij gjykimi nxënësit vendosin në një vijë minus-plus e cila përmbledh vlerësimin nga „shumë i kënaqur“ (+) deri në „mjaft i pakënaqur“ (-).

- 2 Tashmë secili prej nxënësve argumentojnë fushën personale të profesionit personal, pra përse ai e dëshiron ose jo të vazhdojë këtë shkollë: „Ky profesion më intereson, por shkollimi zgjat.“ „Për këtë profesion nuk ka asnjë shkollë afër shtëpisë sime.“ „Me këtë profesion fiton shumë para.“
- 3 Mësimdhënësi i shkruan kategoritë, sipas të cilave kanë gjykuar nxënësit në flipchart. Tani nxënësit duhet të gjykojnë në lidhje me kategoritë dhe si ndihmë mund të përdorin pyetjen: „Cilat kriteret janë për ty shumë të rëndësishëm për zgjedhjen e shkollës?“

### Detyrë shtëpie

Nxënësit ngarkohen me detyrën, që të mbledhin artikuj nga gazeta dhe revista (eventualisht online) për temën „Shkollimi dhe profesioni“. Në një orë tjetër mësimi shikohet, se në cilët artikuj janë trajtuar kriteret për zgjedhjen e profesionit.

### Udhëzime për mësimdhënësit

- Kërkoni nga pjesëmarrësit që të hulumtojnë në Busullë shkollat që do ti përgatisin më mirë, krahasojnë llojet e shkollave, dhe analizojnë gjendjen në treg të profesioneve të dëshiruara, si dhe të profesioneve të mundshme alternative.
- Inkurajoni pjesëmarrësit të bëjnë një poster për atë shkollë, mund të shërbehen me të dhënat edhe nga interneti (drejtpërdrejtë, ose në punëtori).



### Kriteret për zgjedhjen e shkollës

Kriteret	Vlerësimi
Interesi	X X X X
Aftësitë	X X X X
Mundësitë e shkollimit afër shtëpisë	X
Imazhi i shkollës	X X X
Mundësitë për të fituar pas mbarimit të shkollës	X X X X X
Shanset për karrierë	X X X
Shanset në tregun e punës	X X X
Klima në shkollë	X

### Propozime për kriteret e kombinimit

Profesione me traditë – profesione pa traditë
Profesione tipike për meshkuj – profesione tipike për femra
Profesione me një respekt të lartë në shoqëri
Profesione me mundësi të mëdha për të fituar
Profesione me një shkollim që zgjat shumë kohë
Profesione të preferuara – profesione më pak të preferuara
Profesione kreative – profesione më pak kreative
Profesione të parrezikshme – profesione të rrezikshme
Profesione të lodhshme – profesione më pak të lodhshme

### 3.3 Trajtimi i informacioneve

Ky sesion ndihmon pjesëmarrësit të bëjnë vlerësim për sasinë e informacioneve të marra për shkollën/profesionin e dëshiruar. Është i rëndësishëm aftësimi i nxënësve për mbledhjen e pavarur dhe shqyrtimin e informatave relevante në lidhje me kërkesat që janë vendosur në kuadër të shkollimit dhe profesionit të mëtutjeshëm.

#### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- marrjen e informacioneve të rëndësishme për sistemet arsimore (fletëpalosje);
- trajtimin e aspekteve të rëndësishme (kohëzgjatja, kërkesat, pikat kryesore, temat, të drejtat etj.) për të gjitha shkollat më të larta;
- mësimin se si mund të realizohet prezantimi në grup;
- trajtimin e rrugëve individuale të shkollimit në funksion të profesionit të tyre të dëshiruar.

#### Aktivitet

##### Ushtrim grupor

- 1 Nxënësit kërkojnë informacione për sistemin arsimor (p.sh. Busulla.com) në internet ose mësimdhënësi u jep atyre materiale informuese (p.sh. fletëpalosje).
- 2 Gjatë bisedave në klasë nxënësit trajtojnë aspekte të ndryshme nga

materialet informuese:

Çfarë shkollash më të larta ekzistojnë?

Çfarë i dallon këto shkolla?

Çfarë drejtime/profile mësimore ofrohen?

Çfarë mundësish (mundësi shkollimi,

tregu i punës etj.) kam unë pas

përfundimit të kësaj shkolle?

- 3 Nxënësit përpunojnë brenda grupit kërkesat e shkollës për të cilën diskutohet. Për çdo lloj shkolle hartohet një pllakatë, e cila duhet të përmbajë aspektet në vijim:

Çfarë mësohet në shkollë?

A jam në gjendje të arrij unë atë që kërkon shkolla?

Cilat nga aftësitë dhe interesat e mia

përputhen me kërkesat e shkollës?

Çfarë mundësish (mundësi shkollimi,

tregu i punës etj.) kam unë pas

përfundimit të kësaj shkolle?

- 4 Më pas gjatë prezantimit të përbashkët të rezultateve të grupeve, prezantohen aspektet më të rëndësishme të secilit tip shkolle.

- 5 Secili prej nxënësve paraqet në portofolin e tij shkollën që do të ndjekë për të plotësuar dëshirën e tij në lidhje me profesionin e dëshiruar dhe merr informacione të sakta tek këshilltarët profesionalë/ këshilltari për karrierë – në rast se është mundur – edhe nga interneti për shkollën ezgjedhur.

#### Udhëzime për mësimdhënësit

- Shpjegon rëndësinë e arritjes së pavarur deri te informacioni dhe zhvillimi i kompetencave për vlerësimin e aftësive, interesave si dhe kompetencave digjitale.
- Shpjegon rëndësinë e informatave për t'i marr në konsideratë gjatë marrjes së vendimit për karrierë.

## 3.4 Intervista për profesionet dhe rrugët e shkollimit

### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- zhvillimin e shkathhtësive komunikuese, bashkëpunimin dhe përshkrimin e kualifikimeve në kuadër të profesioneve;
- zhvillimin e kompetencave për përgatitjen e intervistës së realizuar me përfaqësuesit e profesionit.

### Aktivitet

Përgatitja e një interviste: Planifikohet realizimi i intervistave me punëmarrës, sipërmarrës, përfaqësues të shkollave më të larta (drejtorë, drejtues shkencorë, etj.).

Dëshirat paraqiten në plenum dhe hartohet një listë me personat që do të ftohen.

### Ushtrim në çifte

Në grup me partnerin nxënësit mbajnë shënim se cilat informacione janë shumë të rëndësishme për planifikimin e karrierës së tyre. Në punë me partnerin ata mbledhin pyetje dhe i shkruajnë ato nëpër kartela. Secili prej çifteve bën prezantimin e pyetjeve të tyre dhe i vendos kartelat në tabelë (ose i vendos në tokë).

### Puna grupore

Bashkërisht bëhet në klasë një përzgjedhje e pyetjeve dhe hartohet një katalog me pyetje për intervistat. Eventualisht bëhet krahasimi i pyetjeve me listen e propozuar të pyetjeve dhe mund të kombinohen.

Bëhet ndarja e detyrave për nxënësit:

Reporterët bëjnë pyetjet: Këta nxënës marrin

në pyetje personat, të cilët janë ftuar nga trupa mësimore, duke u bazuar tek pyetjet e hartuara dhe mbajnë shënime. Në rast se ekziston një aparat incizimi, një i ashtuquajtur “teknik zëri”, bëhet regjistrimi i bisedës ose telefoni i mençur. Një nxënës, i ashtuquajtur “fotograf” bën fotografimin e të intervistuarit dhe i përdor fotografitë për dokumentimin. Mbledhësi i materialit: mbledh materiale si prospekte dhe shkrime informuese, materiale të printuar nga interneti etj.

Nxënësit mund t’i ndryshojnë funksionet e tyre. Në rast se do të bëhen disa intervista, atëherë duhet të punojnë në disa grupe të ndryshme.

Pas realizimit të intervistave, bazuar në shënimet e bëra, nxënësit krijojnë një fletëpalosje / një kolazh për portofolin e orientimit profesional duke mbajtur parasysh pikat në vijim: profesionet, shkollimi, anët pozitive dhe negative, kërkesat, pagesat/pagat, etj.

Nxënësit prezantojnë rezultatet e tyre.

Bashkë me mësimdhënësin bëhet edhe një herë përmbledhja e rezultateve më të rëndësishme dhe ato paraqiten në një pllakatë/flipchart.

### Udhëzime shtesë

Mundësisht të ftohen punonjës dhe sipërmarrës, të cilët ushtrojnë ato profesione, që u përgjigjen dëshirave dhe interesave profesionale të nxënësve dhe që mund të informojnë hollësisht në lidhje me kërkesat dhe shkollimin (shkollat më të larta).

### Udhëzime për mësimdhënësit

- Bëni ftesa për intervista me punëmarrës, sipërmarrës, përfaqësues të shkollave më të larta (drejtorë, drejtues shkencorë, etj.) të bëhet në bashkëpunim me nxënësit.
- Jepuni nxënësve të gjitha udhëzimet e nevojshme për intervistën e suksesshme me profesionistët e ftuar në shkolla.

**Lista e pyetjeve gjatë intervistës me profesionistë**

Pyetje specifike për profesionin

- Çfarë bëni në një ditë të zakonshme në këtë profesion?
- Çfarë trajnimi apo edukimi kërkohet për këtë lloj pune?
- Cilat cilësi apo aftësi personale janë të rëndësishme për të qenë të suksesshëm në këtë punë?
- Cilat janë kualifikimet ideale për dikë në këtë punë?
- Çfarë lloj edukimi/ trajnimi nevojitet për këtë profesion?
- Cila pjesë e kësaj pune ju duket më e kënaqshme? Më sfiduese?
- Si e gjetët punën tuaj?
- Si e shihni ndryshimin e vendeve të punës në këtë fushë në të ardhmen?
- A ka kërkesë në tregun e punës për njerëz në këtë profesion?
- Me informacionin që keni për arsimimin, aftësitë dhe përvojën time, cilat fusha apo punë të tjera do të sugjeronit që të hulumtoj më tej, përpara se të marr një vendim përfundimtar?

**Pyetje për karrierën**

- Çfarë mundësish për avancim ka në këtë fushë?
- Cilat janë nivelet e pagave për nivele të ndryshme në këtë fushë?
- Cilat janë parakushtet bazë të arsimit/ trajnimit/përvojës për punë në këtë fushë?
- Çfarë këshille të veçantë do t'i jepnit një personi që hyn në këtë fushë?
- Cilat revista dhe organizata profesionale do të më ndihmonin të mësoja më shumë rreth kësaj fushe?
- Çfarë mendoni për përvojën që keni pasur deri më tani përsa i përket hyrjes në këtë fushë?
- Nga këndvështrimi juaj, cilat janë problemet që shihni duke punuar në këtë fushë?
- Nëse do të mund t'i bënit gjërat përsëri, a do të zgjidhnit të njëjtën rrugë për veten tuaj? Pse?

## 4. Takimet reale

### 4.1 Përgatitjet për takimet reale për hulumtimin e profesioneve

Takimet reale me botën e punës ofrojnë mundësi për testimin e profesioneve dhe provimin e vetës në profesionin e caktuar, para se ta zgjedhë. Shkolla ka mundësi të avancojë cilësinë e punës së vet dhe realizimit të një sërë manifestimesh një ditore nga fusha e takimeve reale: Dita e vajzave, panairë edukimi dhe të karrierës, takimi me përfaqësuesit e profesioneve, dita e dyerëve të hapura, vizita në qendrat e karrierës në shkollat profesionale në regjionin e tyre, etj.

Këto manifestime për të rinjtë do t'i ndihmojnë të plotësojnë dhe pasurojnë njohuritë e veta për botën e punës dhe t'i kontribuojnë cilësisë së vendimit për karrierë dhe ndërtimit të sigurisë në zgjedhjet personale.

#### **Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimore përfshijnë:**

- kuptimin e rëndësisë dhe përfitimet nga takimet reale;
- njohjen e elementeve dhe fazave të takimeve reale – përgatitja për hulumtimin e profesioneve;
- inkurajimin për takime reale me shkollën e mesme të lartë;
- njohjen e rregullave të aplikimit me shkrim;
- vetëdijesimin për rëndësinë e krijimit të kushteve nga shkollat e mesme të larta për pranimin e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta gjatë realizimit të takimeve reale.

#### **Aktivitet**

##### **Ushtrim grupor**

Përgatitja e simulimit dhe ndarja në dy grupe:

Mësimdhënësi përshkruan informatat e përmbledhura në manifestimin e: Ditës së dyerëve të hapura në shkollën e mesme të lartë. Atë ditë, mësimdhënësit dhe nxënësit e caktuar janë në dispozicion të nxënësve të shkollave e mesme të ulta për çdo pyetje dhe informacion për shkollën. Theksohet rëndësia e përgatitjes përmes simulimit para shkuarjes në vizitë të ditëve të dyerëve të hapura. Është e nevojshme që të paraqiten vullnetarë për luajtjen rolit gjatë simulimit.

Njërit grup i është dhënë si detyrë ta paraqesë ditën e dyerëve të hapura në ndonjë shkollë të mesme të lartë në drejtimin më pozitiv, me përgatitjen paraprake të nxënësve, me formulimin e pyetjeve për të gjithë përfaqësuesit e shkollës, me definimin e rregullave të sjelljes. Përderisa grupi tjetër duhet të paraqesë shkuarjen në ditën e dyerëve të hapura në variantin negativ, pa përgatitjen e të dy palëve.

Rolet për nxënësit e të dy grupeve: drejtori, bashkëpunëtorja profesionale, mësimdhënësi në detyrë, mësimdhënësi i lëndës, mësimdhënësi i edukimit në karrierë, kujdestari i klasës, nxënësit e shkollës e mesme të ulët dhe ata të shkollës së mesme të lartë.

Në fund nxënësve u jepen materialet e përgatitura më poshtë (Si të beni një intervistë joformale dhe Lista e pyetjeve gjatë takimeve reale në kompani si dhe Rregullat për ta caktuar takimin me shkrim dhe telefon).

## Si të bëni një intervistë joformale

**VENDOSNI** se për cilën punë ose fushë pune dëshironi të mësoni.

**IDENTIFIKONI PERSONAT PËR INTERVISTIM.** Telefononi biznesin dhe kërkoni emrin e personit që është në krye të njësisë, departamentit ose profesionit për të cilin jeni të interesuar.

**PËRGATITJET PËR INTERVISTË.** Lexoni gjithçka që mundeni për punën ose industrinë para se të shkoni në intervistë.

Ju mund të shikoni faqen e internetit të sektorit ose një faqe interneti të kompanisë për informacion.

Vendosni se çfarë informacioni është i rëndësishëm të dini për punën dhe përgatitni një listë pyetjesh të cilave do të dëshironit t'i përgjigjeshit. Merrni listën e pyetjeve më poshtë me vete në intervistë.



## Rregullat për ta caktuar takimin real me shkrim ose me telefon

### Këshilla me telefon

Këshillat përfshijnë disa nga pikat si më poshtë:

- Bëni kërtime për kompaninë përpara se të telefononi.
- Përgatituni paraprakisht për atë që keni nevojë të thoni; mund edhe të shkruani një skenar.
- Mbani përpara vetes çdo letër apo informacion që ju nevojitet.
- Sigurohuni që jeni në një vend të qetë ku nuk do të shqetësoheni.
- Mbani gati një letër dhe laps ose ndonjë formë tjetër për të regjistruar informacionin.
- Flisni direkt në pjesën e mikrofonit.
- Flisni qartë dhe hareshëm.
- Dëgjoni me vëmendje.
- Shmangni bërjen e komenteve negative në lidhje me veten dhe mos thoni asgjë negative.

- të jetë e shkruar me logjikë;
- të përdorë formatin korrekt të biznesit;
- të përfshijë të gjithë informacionin e nevojshëm;
- të jetë jo më shumë se një faqe.

### Përmbajtja e një letre ose një email

Letra ose mesazhi elektronik duhet:

- Ta prezantojë nxënësin të punëdhënësi/punonjësi;
- Të tregojë arsyen e kërkesës për takim;
- Të tregojë se si ka gjetur kontaktin a tij/saj;
- Të përshkruajë vetën e tij ose saj;
- Të shprehë interesin për t'u takuar me punëdhënësin/punonjësin;
- Të falënderoj për kohën dhe konsideratën për ta caktuar takimin.

### Këshilla për kërkesë me letër ose email

Lista duhet të përfshijë ide që lidhen si me përmbajtjen edhe me paraqitjen. Letra/emailli duhet:

- të jetë e rregullt dhe e pastër;
- të jetë e shkruar me kompjuter;
- të lexohet me lehtësi;
- të jetë korrekte nga ana gramatikore dhe ortografike (përdorni funksionin i kontrollit gramatikor dhe ortografik.);



## 4.2 Aplikimi për trajnim dhe punë, CV-të

CV është një dokument i shkurtër që ju jep një shans për t'i treguar një punëdhënësi të mundshëm më të mirën nga ajo që keni. Ajo mundëson të shfaqni shisni aftësitë, përvojën tuaj dhe t'u tregon atyre se ju jeni personi i duhur për një punë që aplikoni. Të bësh një përshtypje të mirë është e rëndësishme në tregun konkurrues të sotëm të punës.

Në shumicën e situatave, një CV është kontakti i parë që keni me një punëdhënësi të mundshëm dhe është shansi juaj për të bërë një përshtypje të parë të mirë.

### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- mësimin se si duhet të plotësojnë një CV të tyre personale;
- identifikimin e informatave të nevojshme që nevojiten të jenë në CV;

#### Udhëzime për mësuesin

- Shpjegojuni për CV-të, formularët e aplikimit, letrat e aplikimit, etj.;
- Jepni këshilla të rëndësishme që ata duhet ti mbajnë në mend kur plotësojnë një CV në të ardhmen.

### Lista si duhet bërë plotësimi i CV-së

- Përpunoni tekstin e CV-së nëse keni mundësi.
- Bëni planin e CV-së tuaj me kujdes para se ta shtypni.
- Ndikimi vizual është shumë me rëndësi – mendoni për formën që do ta përdorni dhe mënyrën e printimit.
- Përqëndrohuni në më së shumti dy faqe.
- Sigurohuni që forma juaj të jetë në përputhje - të ketë hapësirë të njëjtë ndërmjet titujve etj.
- CV juaj duhet të jetë në formë të njëjtë me CV ku aplikoni ju, dhe të theksoni shkathhtësitë, aftësitë dhe cilësitë që do të regonin se jeni person ideal për atë punë.
- Titujt/Pjesët themelore të CV janë:
  - 1 Të dhënat personale – emri dhe mbiemri
  - 2 Edukimi dhe Kualifikimi – lëndët dhe notat
  - 3 Përvoja në punë – puna me gjysmë orari, përvoja me familje, angazhime në aktivitete në shkollë apo organizime në komunitet, pune vullnetare, etj.
  - 4 Të arriturat – çmimet speciale, pozitat me përgjegjësi
  - 5 Interesat – hobi, sportet, interesime të tjera
  - 5 Referencat - Dy njerëz që mund të dëshmojnë karakteristikat tuaja

- përforsimin e asaj që kanë mësuar duke krahasuar CV-të e tyre personale me nxënësit tjerë.

#### Aktivitet

Kërkoni nga pjesëmarrësit të identifikojnë informatat e nevojshme që në përgjithësi nevojiten të jenë në CV-, listën e titujve themelorë. Diskutoni me pjesëmarrësit rrugët kryesore për aplikim në trajnim, punë, etj.

Klasifikoni listën e plotë; duke përdorur titujt e përgatitur në këtë listë dhe kërkoni nga pjesëmarrësit ta formojnë CV e tyre personale.

Duke punuar në çifte, kërkoni nga pjesëmarrësit të krahasojnë CV-të e tyre personale.

## 5. Vendimi për zgjedhjen e profesionit

### 5.1 Preferencat personale në marrjen e vendimit për zgjedhjen e shkollës/profesionit

Informacioni që hulumtoni për institucionet e arsimit/trajnimin dhe tendencat e tregut të punës ju ofron një bazë të mirë informacioni, por ka faktorë të tjerë personalë që mund t'i shtoni tani për t'iu ndihmuar në vendimmarrjen tuaj

Marrja e një vendimi për një karrierë është e rëndësishme, nëse në fillim bëni zgjedhjen e gabuar, nuk është fatale. Mbani në mend se zgjedhja që po bëni tani nuk duhet të jetë e përsosur. Është më e mira që mund të bëni bazuar në atë që dini për veten dhe tregun e punës në këtë moment.

#### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- të kuptuarit e stadi të tyre se deri ku kanë arritur para marrjes së një vendim mbi profesionin;
- definonin e të priturve nga profesioni dhe njoftimi me të priturat e moshatarëve;
- bëni përputhjen në mes të zgjedhjes së shkollës respektivisht profesionit dhe kënaqësisë në punë;
- vendosni prioritete që përfaqësojnë idetë e

tyre personale;

- Krahasoni pritjet personale me realitetin e profesionit.

#### Aktivitet

##### Punë individuale dhe plenum

Se pari nxënësve i'u shpërndahet "Hulumtimi i informacioneve për karrierë" për ta lexuar dhe plotësuar atë në mënyrë individuale. Nxënësit e arsyetojnë para panelit preferencat e tyre dhe zgjedhjet që kanë bërë.

Shënohen në flipchart zgjedhjet e nxënësve për shkollat/profesionet e tyre të ardhshme.

Mësimdhënësi shpjegon se çdo veprim apo vendim vjen me një sasi të caktuar rreziku, ekziston gjithmonë një nivel pasigurie që vjen me zgjedhjet e karrierës prandaj ata duhet të besojnë në aftësinë e tyre për të vendosur, mësuar dhe përshtatur me ndryshimet.

#### Udhëzime për mësimdhënësit

- Shpjegoni rëndësinë e vlerësimit të informatave para vendimit për zgjedhjen e shkollës/karrierës.
- Informoni për rëndësinë e preferencave dhe prioriteteve të tyre për zgjedhjen e shkollës/profesionit.

### Hulumtimi i informacioneve për karrierë

Ju lutem hulumtoni informacione për vendimmarrje gjatë gjithë kohës: për të blerë një celular brenda buxhetit tuaj, për të zgjedhur dyqanin ushqimor që i përshtatet nevojave tuaja për produktet, ndjekja e kurseve private, etj.

Ju tashmë keni aftësi kërkimore. Por ju mund të MOS keni përvojë në përdorimin e këtyre aftësive për të hulumtuar informacionin profesional.

Për t'u siguruar që zgjedhja juaj është e mirëinformuar, duhet të ndiqni 3 hapa:

- Mblidhni informacione nga media elektronike, të shtypura (përdorni porfolion e përgatitur);
- Mblidhni informacione nga njerëzit: miqtë, të afërmit, punëdhënësit, punonjësit;
- Krahasoni dhe vlerësoni opsionet tuaja të zgjedhura për një përputhje të mirë karrierë.

Rendisni profesionet që mendoni që ju përshtaten pasi të keni bërë hulumtimin tuaj.

Këto profesione kanë VLERËSIMET MË LARTA nga hulumtimi:

- 1 \_\_\_\_\_
- 2 \_\_\_\_\_
- 3 \_\_\_\_\_

Kjo fletë pune do t'ju ndihmojë të vendosni se cili prej këtyre opsioneve ka të ngjarë të jetë më i përshtatshmi për ju. Mos harroni, për aq sa është e rëndësishme marrja e një vendimi për një karrierë, nuk është fatale, edhe nëse në fillim bëni një zgjedhje të gabuar. Mbani në mend se zgjedhja që po bëni tani nuk duhet të jetë e përsosur. Është më e mira që mund të bëni bazuar në atë që dini për veten dhe tregun e punës në këtë moment.

Informacioni që keni hulumtuar në seksionet e më parshme ka dhënë një bazë të mirë informacioni, por ka faktorë të tjerë personalë që mund t'i shtoni tani për t'ju ndihmuar të merrni vendimin tuaj. Plotësoni këtë fletë pune dhe më pas merrni parasysh se si përgjigjet tuaja mund t'ju ndihmojnë të vendosni midis 3 profesioneve të listuara më sipër.

### Vendet e punës - Preferencat e mia

Mjedisi juaj i punës është vendi ku do të kaloni orët tuaja të punës, kështu që në mënyrë ideale është diku ku duhet të ndiheni mirë. Mendoni se çfarë është e rëndësishme për ju. A keni nevojë të jeni jashtë?

Dëshironi shumë dritare? A do të ishit më të lumtur në një tavolinë në zonën tuaj private, apo do të punonit krah për krah me të tjerët? A është e rëndësishme që të lëvizni shumë?

Për sa i përket mjedisit apo atmosferës së punës, e di që dua:

---

---

---

Mund të më duhet/dua të mësoj më shumë rreth:

---

---

---

Ku të shkoni:

- Pyesni punëdhënësit dhe punonjësit lokal.
- Gjeni kompanitë lokale në agjencinë për regjistrimin e bizneseve në Kosovë dhe përdorni aftësitë tuaja të intervistimit për të mbledhur informacion.

### Mundësitë Lokale

Ju mund të jeni të lumtur të lëvizni për të gjetur punën që dëshironi, ose mund të jetë e rëndësishme për ju të qëndroni në qytetin/fshatin tuaj. Sido që të jetë, ju duhet të dini se çfarë është në dispozicion në nivel lokal.

Për sa i përket mundësive lokale të punës për 3 profesionet që po shqyrtoj, e di që mund të më duhet/dua të mësoj më shumë rreth:

Ku të shkoni:

- Pyesni punëdhënësit dhe punonjësit lokalë.
- Gjeni kompanitë lokale në Agjencinë për regjistrimin e bizneseve në Kosovë dhe përdorni aftësitë tuaja për intervistim për të mbledhur informacion.

### Arsimimi -Trajnimi - Preferencat e mia

Është e rëndësishme të dini sa më shumë për kërkesat arsimore të profesioneve që po shqyrtoni dhe sa e lehtë/e vështirë do të jetë për ju t'i përmbushni ato.

A e dini nëse do të keni nevojë për vazhdimin e shkollës përpara se të filloni trajnimin profesional? Sa vite/muaj jeni të gatshëm të shpenzoni për arsimim/trajnim? Sa larg mund të udhëtoni për të bërë arsimimin/trajnimin tuaj? Cilat mundësi financimi janë në dispozicion për ju për të paguar për arsimimin/trajnimin e dëshiruar?

Mund të më duhet/dua të mësoj më shumë rreth:

---



---



---

Ku mund të shikoni:

Ekziston një listë e INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE INFORMACIONI PËR PRAKTIKË (në komunën tuaj). Për të mësuar më shumë se ku mund të studioni ose trajnoheni brenda ose jashtë komunës/rajonit tuaj dhe informacion mbi kërkesat, vizitoni [www.busulla.com](http://www.busulla.com).

Pasi të keni në mendje një program specifik për arsim/trajnimi në rajonin tuaj, vizitoni websajtin e tyre, telefonojini ose – akoma më mirë – lini një takim për të vizituar dhe biseduar me dikë atje. Mësoni për programin, kërkesat e pranimit, sa kohë zgjat, çfarë pritet nga nxënësit/studentët, qasja e tyre ndaj mësimit, sa kushton (nëse është shkolle private), si të aplikoni dhe kur fillon.

Aktivitetet ditore- Preferencat e mia

Shumë shpesh, njerëzit arsimohen/trajnohen për një karriere të caktuar, por me vonë pasi fillojnë punën zbulojnë se nuk u pëlqen puna pasi ta realizojnë atë. A ju pëlqen të organizoni dosje, të përdorni pajisje të mëdha, të merreni me publikun apo të punoni në ekranin e kompjuterit? Cilat aktivitete të përditshme përfshihen në profesionet që po i merrni në konsideratë?

Përsa i përket aktiviteteve të përditshme, e di që;

Mua më pëlqen pëlqen : \_\_\_\_\_

Mund të më duhet/dua të mësoj më shumë rreth:

Ku të shkojnë:

- Pyesni punëdhënësit dhe punonjësit lokal.
- Vizitoni [www.busulla.com](http://www.busulla.com) për videot e njerëzve që punojnë. Nëse keni nevojë për informata shtese, Qendrën e Karrierës nëse ka në regjionin tuaj ose shërbimin publik të punësimit.

### Puna me të tjerët - Preferencat e mia

Kur bëhet fjalë për punën, a ju pëlqen të punoni vetëm apo keni nevojë për shumë ndërveprim me të tjerët? Ju pëlqen një vend pune me shumë biseda dhe të qeshura, apo preferoni heshtjen? A ju pëlqen të jeni të mbikëqyrur nga afër, apo të lihet t'i kuptoni gjërat vetë? Dëshironi të jeni pjesë e vendimmarrjes apo dëshironi që thjesht t'ju thuhet se çfarë të bëni?

Për sa i përket punës me të tjerët, e di që më pëlqejnë:

---

---

---

Mund të më duhet/dua të mësoj më shumë rreth:

---

---

---

Duke parë fletët tuaja të punës, mendoni se si "përshtaten" 3 profesionet që po

konsideroni me preferencat tuaja personale. Me të gjithë informacionin që keni mbledhur deri më tani, mund të jeni gati tani për t'u kufizuar në një profesion (të paktën tani për tani) që dëshironi ta zgjedhni.

#### MBANI MEND:

Çdo veprim apo vendim vjen me një sasi të caktuar rreziku. Ekziston gjithmonë një nivel pasigurie që vjen me zgjedhjet e karrierës. Besoni në aftësinë tuaj për të vendosur, mësuar dhe përshtatur me ndryshimin.

## 5.2 Marrja e vendimit për karrierë

Marrja e vendimeve ndihmon për të kuptuar nevojën për të planifikuar, për t'i dhënë përparësi dhe për të hulumtuar opsionet e hapura për ata. Nxënësit duhet të identifikojnë një proces vendimmarrjeje me të cilin janë njohur. Mund të jetë blerja e një palë këpucë stërvitje ose një biçikletë.

Ata duhet të zbulojnë se cilat agjenci dhe individë kanë informacionin për t'i ndihmuar ata të kuptojnë nevojën për të planifikuar, për të dhënë përparësi dhe për të kërkuar opsione të hapura për ta.

### Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:

- të jenë nxënësit në gjendje të shprehin dëshirat e përgjithshme për profesionin e admiruar;
- zhvillojnë vetë iniciativë në marrjen e vendimit në përzgjedhjen e shkollimit dhe profesionit në të ardhmen;
- zhvillojnë aftësitë e shprehjes së mendimit personal dhe aftësitë e vetë-vlerësimit;
- njohjen e faktorëve me ndikim në vendimmarrjen e tyre;
- vlerësojnë rëndësinë e prindërve në vendimmarrje dhe adresojnë drejtë aspiratat e tyre tek prindërit.

### Aktivitet

#### Punë individuale dhe plenare

Pjesëmarrësit duhet të identifikojnë procesin e marrjes së vendimit më të cilin ata janë njohur. Mund të jetë blerja e patikeve ose trotinetit.

Se pari nxënësve i'u shpërndahet fleta/dokumenti "Marrja e vendimit" për ta lexuar dhe pastaj i'u shpërndahet materiali "Formulari për ta plotësuar" në mënyrë individuale për variantet e tyre të zgjedhura. Nxënësit plotësojnë formularin dhe pastaj reflektojnë/

prezantojnë para klasës dhe panelit.

Shembulli është në lidhje me zgjedhjen e pushimeve - por ju mund të lejoni pjesëmarrësit të identifikojnë ata vetë shembullin e tyre personal.

Përdorni titujt dallues në shembujt e përgatitur që nxënësit të diskutojnë dhe skicojnë procesin për variantet e tyre të zgjedhura.

Kërkoni që ata të paraqesin zgjedhjet e tyre në plenum dhe të fillojnë përsëri procesin për punë/procesin e trajnimit për të treguar ngjashmëritë.

Në fund jepuni nxënësve për të plotësuar "Rëndësia e prindërve gjatë marrjes së vendimit".

### Gjatë marrjes së vendimit merrni parasysh si më poshtë:

- Identifikoni të gjitha variantet në dispozicion.
- Vendosni çka doni në të vërtetë
- Zbatoni atë çka përpiqeni të keni më të vërtetë.
- Sa kanë rëndësi aspektet e ndryshme - a janë disa më të rëndësishme se të tjerat?
- Identifikoni ku mund të gjinden informatat e përshtatshme.
- Gjeni cilat agjenci dhe cilët persona kanë informata.



## Marrja e vendimit

SHKOJ NË...	PËRDOR	ÇKA DËSHIRONI?	KU TA GJENI ATË?	ÇKA ËSHTË NË DISPOZICION?
<b>PUSHIME</b>	Paratë, të ardhurat kursimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përcaktimet e përgjithshme p.sh Shqipëri, Syri i kaltër.</li> <li>● Ambienti p.sh. nxehtë, deti, plazhi</li> <li>● Strehimi p.sh. hotel, tenda, banesë private</li> <li>● Udhëtimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Agjension turistik</li> <li>● Facebook</li> <li>● Internet (webfaqe të ndryshme)</li> <li>● Reklamat në media</li> <li>● Panaire të turizmit</li> </ul>	Pako turistike (pansion i plotë ose gjysëm pansion)
<b>PUNA/TRAJNIMI</b>	Aftësitë Cilësitë Diplomat/kualifikimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Grupi i punëve të ngjashme</li> <li>● Puna specifike p.sh. Hidraulik</li> <li>● Të punuarit jashtë</li> <li>● Udhëtimi</li> <li>● Puna më ndërrime</li> <li>● Paratë</li> <li>● Pozita</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Këshillimet për karrierë</li> <li>● Biblioteka për karrierë</li> <li>● Interneti</li> <li>● Letrat/ Revistat</li> <li>● Përgatitjet për trajnim</li> <li>● Punëdhënësit</li> </ul>	p.sh. i trajnuari për hidraulikë (Shkolla profesionale "Shtjefen Gjeqovi" Prishtinë)

**Formulari për plotësim (marrja e vendimit)**

SHKOJ NË...	PËRDOR	ÇKA DËSHIRONI?	KU TA GJENI ATË?	ÇKA ËSHTË NË DISPOZICION?
-------------	--------	----------------	------------------	---------------------------

**Rëndësia e prindërve gjatë marrjes së vendimit**

PRINDËRIT E MI ...	
... përzihen shumë në vendimmarrjen time.	<input type="checkbox"/>
... nuk interesohen fare, se cilin profesion do të zgjedh unë.	<input type="checkbox"/>
... më mbështesin, për të gjetur një sektor të përshtatshëm, por nuk marrin asnjë vendim.	<input type="checkbox"/>
... përpiqen, të më imponojnë ndonjë vendim, i cili nuk më intereson fare.	<input type="checkbox"/>
... ma lenë mua në dorë, se për cilin profesion do të vendos unë.	<input type="checkbox"/>
... më japin shumë këshilla të mira, se si mund ta gjej një punë të përshtatshme, dhe kjo gjë më gëzon.	<input type="checkbox"/>
... më mirë le të merren me punët e tyre, se sa të më japin gjithmonë këshilla.	<input type="checkbox"/>

### 5.3 Plani i veprimit për karrierë

**Objektivat mësimore që lidhen me këto mësimet përfshijnë:**

- për t'ju ndihmuar nxënësve të përqendrohen në atë që dëshirojnë të bëjnë në të ardhmen dhe hapat që duhet të ndër marrin gjatë hartimit të Planit të tyre Personal të Veprimit.

**Udhëzime për mësimdhënësit**

- Informoni ata që plani i veprimit duhet të mbahet i përditësuar. Kjo është një mënyrë e dobishme për të kuptuar se cilat janë pikat kryesore për atë që ata dëshirojnë dhe çfarë mund të ofrojnë.
- Informoni se përgjegjësia dhe përpjekja për të ecur përpara duhet të vijë nga ata.

**Udhëzim** - Mundohuni të shkruani fjali dhe jo përgjigje me një fjalë – shkruani sikur po ia shpjegoni planin tuaj dikujt tjetër.

Emri: \_\_\_\_\_

Ditëlindja \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

**Cili është qëllimi juaj për hapin tuaj të ardhshëm?**

Aktualisht synimi im kryesor është

---

---

---

---

---

**Mendoni për të paktën 3 arsye pse kjo ju tërheq. Thuaj pse mendon se do të pëlqente.**

Arsyet që do të më pëlqente janë

---

---

---

---

---

---

**Mendoni për aftësitë dhe interesat, vlerat dhe karakteristikat personale që keni dhe që do të nevojiten në opsionin që keni zgjedhur të bëni (të paktën 3).**

Arsyet që mendoj se mund të bëj këtë janë:

---

---

---

---

---

---

**Mendoni për çdo përvojë që keni që mund të lidhet me opsionin që keni zgjedhur të bëni.**

Përvoja që mendoj se do të më ndihmonte

---

---

---

---

---

---

**Çfarë do të bëni nëse nuk funksionon zgjedhja juaj e parë?**

Ideja ime mbështetëse është

---

---

---

---

---

---

**Cilat janë arsyet që kjo është ideja juaj rezervë?**

Sepse

---

---

---

---

---

---

**Çfarë informacioni ju nevojitet për të realizuar qëllimin tuaj dhe ku do ta gjeni?**

---

---

---

---

---

---

Çfarë duhet të përgatisni në lidhje me caktimin e një intervistë për takim real me punëdhënës/punonjës?

---

---

---

---

---

---

Si do të mësoni për mundësitë për shkollat e mesme të larta dhe profesionet?

---

---

---

---

---

---

Kush tjetër mund t'ju mbështesë?

---

---

---

---

---

---

**Hapat kryesor të veprimit**

Çfarë duhet të bëni për të ecur drejt arritjes së qëllimit tuaj? Vendosi data për të treguar se kur do t'i përfundoni hapat e veprimit.

---

---

---

---

---

---

## Referencat

- *Udhëzues Administrativ, Qendra Universitare e Bostonit për Gatishmërinë e Ardhshme, 2021* Jaques, E. S. & Solberg, V. S. H. ILP/MyCAP
- *Administrative Guide. Boston University Center for Future Readiness, 2021*
- Jaques, E. S. & Solberg, V. S. H. ILP/MyCAP
- *Fondacioni Kanadez i Zhvillimit të Karrierës, 2015*, Libri i punës për vendim-marrjen e karrierës
- Career Decision-Making Ëorkbook- *The Canadian Career Development Foundation, 2015*
- Edukimi në Karrierë - *Pesë hapat e vendimmarrjes drejt shkollimit dhe profesionit*, Projekti i financuar nga GIZ, 2010, Prishtinë
- Suksesesi (Doracak për edukimin dhe orientimin në karrierë), Projekti KosVET financuar nga BE, 2004, Prishtinë





